

RAPORTI I VITIT 2014 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova është demokraci parlamentare. Kushtetuta dhe ligjet parashikojnë një parlament të zgjedhur njëdhomësh (Kuvendin), i cili më pas e zgjedh një kryetar. Kuvendi duhet ta miratojë kryeministrin të cilin e zgjedh kryetari. Vendi i mbajti zgjedhjet parlamentare më 8 qershor, të cilat vëzhguesit ndërkombëtarë i konsideruan të lira e të drejta. Një bllokadë politike vonoi krijimin e qeverisë deri më 9 dhjetor. Këto ishin zgjedhjet e dyta parlamentare që kur vendi shpalli pavarësinë e vet nga Serbia në vitin 2008 dhe zgjedhjet e para të administruara nga qeveria. Me ndihmën e OSBE-së, këto ishin gjithashtu zgjedhjet e para që u mbajtën në tërë vendin, përfshirë katër komunat veriore. Autoritetet civile mbajtën kontrollin mbi forcat e sigurisë. BE-ja ia vazhdoi mandatin Misionit për Sundim të Ligjit (EULEX) deri në qershor të vitit 2016 në një rol të kufizuar. EULEX-i monitoron Policinë e Kosovës (PK) dhe sektorin e drejtësisë në një kapacitet të kufizuar.

Dialogu i Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Beogradit, i mundësuar nga BE-aj, vazhdoi. Në të u trajtuan menaxhimi i integruar i kufirit, arkëtimet doganore dhe vultat, liria e lëvizjes, pranimi i ndërsjellë i diplomave, përfaqësimi dhe bashkëpunimi rajonal, përfshirja e ish-policëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Qeverisë së Serbisë në PK, zgjedhjet, transmissioi i energjisë, regjistrat civilë dhe regjistrat kadastralë. Strukturat administrative të Kosovës veriore u integruan pjesërisht në administratën nacionale. Marrëveshjet për një asociacion të komunave serbe dhe për integrim të sektorit të drejtësisë mbetën pezull.

Veprimet për ta bllokuar normalizimin, përfshirë krijimin e barrikadave në rrugë në Mitrovicën veriore nga zyrtarët lokalë serbë të Kosovës dhe kufizimet mbi të drejtat e tilla, si liria e lëvizjes dhe liria e faljes nga pelegrinët ortodoksë serbë, përbënin problemin më të madh të të drejtave të njeriut. Dhuna dhe diskriminimi shoqëror ndaj anëtarëve të bashkësive pakicë, personave me aftësi të kufizuara dhe anëtarëve të komunitetit të lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjnorëve (LHBT) përbënte fushën e dytë të shqetësimit të madh. Dhuna në familje ndaj femrave ishte problemi i tretë kryesor.

Në probleme të tjera të të drejtave të njeriut përfshiheshin keqtrajtimi i raportuar i të ndaluarve nga policia, kushtet fizike nën standarde në burgje, korrupsioni dhe favoritizmi në burgje, paraburgimi i gjatë dhe joefikasiteti i gjyqësorit, kërcënimi i medieve nga zyrtarët publikë dhe elementët kriminelë, kufizimet mbi lirinë fetare dhe vandalizimi i pronës fetare, përparimi i kufizuar në kthimin e personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre, korrupsioni në Qeveri, trafikimi i personave, kushtet e dobëta në objektet e shëndetit mendor, tensionet sporadike etnike dhe puna e fëmijës në sektorin joformal.

Qeveria ndërmori masa për t'i ndjekur penalisht dhe dënuar zyrtarët që kryen abuzime në shërbime të sigurisë apo gjetiu në Qeveri, ndonëse shumë veta mendonin që zyrtarët e lartë përfshiheshin në korrupsion pa u ndëshkuar.

Seksioni 1. Respektimi i integritetit të personit, përfshirë lirinë nga:

a. Privimi arbitrar ose i paligjshëm i jetës

Nuk pati raportime që Qeveria apo agjentët e saj kryen vrasje arbitrare apo të paligjshme.

KOSOVA

Sulmues të panjohur vranë dy personalitete politike, motivet nuk dihen. Më 14 janar, sulmuesit vranë Dimitrije Janiçjeviqin, anëtari i vetëm i Partisë së Pavarur Liberale në kuvendin komunal në Mitrovicën veriore. Më 14 qershor, një sulmues vrau Elvis Pistën, kandidat për parlament nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Rahovec.

Bastisjet shpurën në disa arrestime në lidhje me vrasjen në vitin 2011 të policit Enver Zymberi, që kishte të bënte me tension etnik. Vrasja e Zymberit ndodhi gjatë një operacioni për ta shtrirë autoritetin e Qeverisë së Kosovës në pjesën veriore të vendit. Policët e EULEX-it e arrestuan Slllobodan Sovërliqin më 12 mars dhe Radovan Radiqin më 11 prill. Dhuna e turmës më pas shpuri në ikjen e Sovërliqit, por autoritetet e arrestuan atë sërish më 15 maj. Më 13 qershor, një gjykatës në Gjykatën Themelore në Mitrovicën veriore e vendosi Sovërliqin në paraburgim. Gjykimi i tij filloi më 18 dhjetor.

Më 8 maj, EULEX-i akuzoi Radiqin dhe Radisha Vuçiqin për përfshirjen e tyre të supozuar në vrasjen e Zymberit. Më 30 gusht, EULEX-i lëshoi fletarrestim për kryetarin e Zubin Potokut, Stevan Vulloviq, dhe ish-“kryetarin paralel”, Sllavisha Ristiç, pasi nuk u paraqitën për t’u intervistuar lidhur me këtë ikje dhe probleme të tjera. Më 7 tetor, rreth 50 policë serbë të PK-së nga Zubin Potoku protestuan para Gjykatës Themelore në Mitrovicën veriore kundër urdhërarresteve të EULEX-it për Vulloviqin dhe Ristiçin. Më 7 tetor, një i dyshuar tjetër, Radomir Kasaloviç, vullnetarisht iu dorëzua EULEX-it afër Zubin Potokut. Autoritetet e liruan atë me dorëzani, por ai u përball me akuza për vrasje të rëndë dhe akuza të tjera. Prokurorët e EULEX-it e intervistuan Ristiçin më 2 dhjetor, por e liruan me kusht që ai të paraqitej në PK. Vulloviq u paraqit vullnetarisht për t’u intervistuar nga prokurorët e EULEX-it më 8 dhjetor. Ai ishte në arrest shtëpiak deri më 19 dhjetor.

Më 22 maj, EULEX-i arrestoi Florim Ejupin dhe Bajram Kiçmarin nën akuzat për terrorizëm në lidhje me vrasjen e dyfishtë të vitit 2004, vrasjen e një zyrtari të UNMIK-ut dhe të një polici gjatë trazirave të shqiptarëve të Kosovës kundër serbëve të Kosovës.

Më 29 korrik, prokurori kryesor i Task Forcës për Hetime Speciale njoftoi se kishte prova bindëse për të ngritur një numër të vogël të aktakuzave kundër ish-zyrtarëve të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) për krime luftime dhe krime kundër njerëzimit të kryera pas vitit 1999. Aktakuzat priten themelimin e një gjykate speciale siç parashihej me shkëmbimin e letrave me të cilat vazhdohej mandati i EULEX-it.

Prokurorët e EULEX-it dhe vendorë vazhduan t’i ndjekin rastet e krimeve të luftës që ndodhën gjatë konfliktit të vitit 1998-1999 që shpuri në pavarësinë e vendit. Në tetor, prokuroria speciale ishte duke hetuar 164 raste të krimeve të luftës. Prokurorët e EULEX-it udhëhoqën 130 raste, kurse prokurorët vendorë 34 raste.

Më 27 janar, EULEX-i arrestoi Olliver Ivanoviçin dhe i kërkonte edhe katër të tjerë nën dyshimin për krime luftime, vrasje të rëndë, tentimvrasje të rëndë dhe shtytje për t’i kryer këto krime në vitin 1999 dhe 2000. Në mars, pasi Ivanoviçi hyri në grevë urie, autoritetet e transferuar atë nga Prishtina në burgun hetues në Mitrovicën veriore dhe ia mohuan lirimin me kusht. Gjykimi i tij filloi më 26 gusht dhe ai nuk e pranoi fajësinë. Më 12 nëntor, një gjykatës i EULEX-it konfirmoi aktakuzën kundër të pesë të pandehurve. Më 18 dhjetor, Ivanoviçi dhe katër të pandehurit e tjerë nuk e pranuan fajësinë për akuzat për krime luftime. Gjykata ua vazhdoi paraburgimin deri më 26 shkurt 2015.

KOSOVA

Në maj dhe qershor, autoritetet arrestuan 17 anëtarë të grupit të ashtuquajtur “Drenica”, ish-pjesëtarë të UÇK-së, për një sërë akuzash për vrasje dhe terrorizëm. Të arrestuarit ishin zyrtarë qeveritarë me lidhje të forta me partinë në pushtet, PDK-në, përfshirë ambasadorin e vendit në Shqipëri, Sylejman Selimi, dhe kryetarin e Skenderajt, Sami Lushtaku. Zyrtarët e akuzuan Selimin me shtatë vepra penale, përfshirë keqtrajtimin e civilëve dhe përdorimin e dhunës kundër së paku një dëshmitari të mbrojtur. Duke marrë parasysh numrin e madh të të pandehurve, trupi gjykues i udhëhequr nga EULEX-i u pajtua me kërkesën e prokurorit për ta ndarë rastin Drenica në dy gjykime të veçanta, me shtatë të pandehur në Drenica I dhe 10 të pandehur në Drenica II. Më 16 dhjetor, një gjykatës i EULEX-it liroi Lushtakun, Selimin dhe katër të pandehur të tjerë të Grupit Drenica I me dorëzani. I pandehuri Sabit Geci ngeli në burg në vuajtje të dënimit për një rast të ndarë të krimeve të luftës. Gjykatësi ua ndaloi të pandehurve të kontaktonin me dëshmitarë, të jepnin deklaratata publike, apo të shkonin në vende ku kishte më tepër se 10 persona të pranishëm. Lushtaku u kthye në postin e tij të kryetarit të komunës pas lirimit.

Më 23 prill, një prokuror i EULEX-it akuzoi gazetarin e RTK-së Mialim Zeka për kërcënim të dëshmitarëve, shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe pengim të të provuarit apo procedurës zyrtare. Në vitin 2013, gazetari kishte intervistuar dëshmitarë “të mbrojtur” të Grupit Drenica të cilët pohonin se prokurorët e EULEX-it i kishin shtrënguar të jepnin dëshmi të rreme kundër disa pjesëtarëve të UÇK-së. Rustem Rukolli, koordinator i mbrojtjes së kryetarit Lushtaku, gjithashtu u përball me akuza për shkelje të fshehtësisë së procedurës. Mediat raportuan se prokurorët i akuzuan Zekën dhe Rrukollin për përpjekje për të ndikuar në një dëshmitar të mbrojtur për ta tërhequr dëshminë e tij.

Më 17 shtator, anëtari i Kuvendit Fatmir Limaj dhe nëntë të tjerë u paraqitën në Gjykatën e Apelit pasi prokurorët e EULEX-it ushtruan ankesë kundër lirimit të tyre në shtator të vitit 2013 nga akuzat për krime lufte lidhur me abuzimet e supozuara në qendrën e ndalimit në Kleçkë në vitin 1999. Në vitin 2005, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë e liroi Limajn nga akuzat për krime lufte lidhur me abuzimet në burgun e Llapushnikut.

Më 2 tetor, Gjykata Supreme i shpalli të pafajshëm serbët e Kosovës Jovica Dejanoviq dhe Gjorgje Bojkoviq për dhunim të një vajze shqiptare 16-vjeçare gjatë kohës së luftës së vitit 1999. Një gjykatës ndërkombëtar që punonte në gjykatë tha se viktimia dha dëshmi kundërthënëse, por Qendra për të Drejtën Humanitare në Kosovë shprehu “shqetësim të madh” për drejtësinë e aktgjykimit.

Më 6 nëntor, një panel i përzier i gjykatësve të EULEX-it e vendorë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë i liroi tre serbë të Kosovës të cilët i rigjykoj për krime lufte të kryera në vitin 1999 kundër dy shqiptarëve të Kosovës. Mediet e cituan gjykatësin Vladimir Mikula të ketë thënë se lirimi rezultoi nga dështimi për t’i hetuar krimet plotësisht. Përfaqësuesit e viktimës njoftuan për qëllimin e tyre për të ushtruar ankesë në Gjykatën Themelore.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje, rrëmbime apo kidnapime me motive politike gjatë këtij viti.

Deri më 13 nëntor, sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), 1.655 persona gjendeshin në listën e personave të zhdukur që nga konflikti i vitit 1998-99. Ndonëse KNKK

KOSOVA

nuk i dallon personat e zhdukur sipas prejardhjes etnike për shkak të kufizimeve për konfidencialitet, vëzhguesit sugjeruan që rreth 70 për qind e tyre ishin shqiptarë të Kosovës dhe 30 për qind ishin serbë të Kosovës dhe pakica të tjera. Të afërmit e personave të zhdukur rregullisht shprehnin frustrim në hapin e ngadalshëm të përparimit të hetimit për këto zhdukje dhe u bënë thirrje autoriteteve në Kosovë dhe Serbi që t'i shtonin përpjekjet e veta për t'i gjetur personat e tjerë.

Përpjekjet për gjetjen e mbetjeve vazhduan. Në gusht dhe shtator, EULEX-i pranoi 52 grupe të mbetjeve mortore të nxjerra nga një varrezë masive në Rashkë, Serbi. Sipas Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, shumica e viktimave, nëse jo të gjitha, ishin rrëmbyer dhe vrarë në Kosovë në vitin 1999 gjatë luftës. Më 29 shtator, prokurori serb për krime lufte, Vlladimir Vukçević, urdhëroi një zhvarrosje të re në një kompleks të policisë speciale në lagjen Batajnica të Beogradit, Serbi. Në vitin 2001-02, në këtë vend ishin gjetur mbetjet e përafërsisht 900 shqiptarëve të Kosovës. Më 6 tetor, Komisioni qeveritar për Persona të Zhdukur bëri verifikimin e tokës së terrenit në fshatin Piskotë në komunën e Gjakovës. Departamenti i EULEX-it për Mjekësi Ligjore dhe Komisioni i Qeverisë së Serbisë për Persona të Zhdukur ishin të pranishëm gjatë verifikimit gjë që kryetari i Komisionit, Prenk Gjetaj, e cilësoi si negative.

c. Torturimi dhe trajtimet apo ndëshkimet e tjera të egra, çnjerëzore apo poshtëruese

Dënimi

Ligji ndalon praktika të tilla, por pati raportime që zyrtarët qeveritarë i përdorën ato.

Vëzhgues vendorë, përfshirë përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) dhe të Qendrës së Kosovës për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRVT), të cilët bënë vizita periodike në burgje, gjetën ankesa të shumta dhe treguan se keqtrajtimi i të burgosurve dhe i të ndaluarve kishte shënuar rritje. Raporti i IAP-it mbi aktivitetet e veta për vitin 2013, i lëshuar në mars, tregoi se gjatë vitit 2013 ai kishte hetuar 23 raste nën rubrikën e parandalimit të torturës dhe trajtimit të egër, çnjerëzor apo poshtërues. Bazuar në intervistat me të burgosur dhe staf, QKRVT konkludoi se kishte pasur rritje të dukshme në keqtrajtimin fizik dhe verbal të të burgosurve nga gardianët në burgun e Dubravës.

Kushtet në burgje dhe qendra ndalimit

Kushtet në burgje dhe qendra të ndalimit në përgjithësi i plotësonin standardet ndërkombëtare, por pati probleme të mëdha në disa institucione. Në këto probleme përfshiheshin lehtësirat e mangëta fizike, dhuna ndërmjet të burgosurve, korrupsioni dhe kujdesi mjekësor nën standarde. Qeveria u lejoi vizita vëzhguesve të pavarur për të drejta të njeriut; IAP-i ishte institucioni i vetëm që kishte qasje të vazhdueshme në qendra korrektuese.

Kushtet fizike: Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) i udhëhoqi punët ditore në të gjitha qendrat korrektuese dhe të ndalimit. EULEX-i mbajti rol të kufizuar monitorues, mentorues dhe këshillues në burgje. Deri më 1 tetor, 1.220 të burgosur të dënuar dhe 596 të paraburgosur ishin të përzier në burgje dhe qendra të ndalimit. 49 femra, 45 të mitur dhe 133 shtetas të huaj ishin në këto burgje dhe qendra të ndalimit. Shërbimi Korrektues raportoi për vdekjen e tre të burgosurve nga shkaqet natyrore dhe për katër vetëvrasje. Qendrat korrektuese në vend mund ta menaxhojnë një popullatë prej përafërsisht 2.447 personash.

KOSOVA

Pati katër qendra korrektuese, gjashtë qendra të ndalimit, një qendër për mbrojtje të dëshmitarëve dhe një spital të burgut.

IAP-i, QKRVT-ja dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, duke vepruar si task forcë, themeluan një Mekanizëm për Preventivë Nacionale (MPN) për t'i vlerësuar kushtet në burgje. MPN konkludoi se kushtet fizike dhe të jetesës mbetën nën standarde në disa objekte në burgun e Dubravës, ku edhe është i vendosur numri më i madh i të burgosurve. Më 26 qershor, MPN i bëri thirrje shërbimit korrektues për t'i meremetuar objektet e burgosjes njësh në burgun e Dubravës apo t'i mbyllë ato. Të metat përfshinin ndriçimin dhe ventilimin e dobët në disa qeli, kuzhinat dhe tualetet e vjetruara, mungesën e ujit të nxehtë dhe shtrojat joadekuate ose mungesën e tyre në disa burgje dhe qendra të ndalimit. Sipas QKRVT-së, pati ujë të pijshëm dhe ushqimi ishte adekuat por i cilësisë së dobët, por intervistat me të burgosur, të paraqitura më 12 nëntor në programin “Drejtësia në Kosovë” të Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), treguan se ushqimi në burgun e Dubravës ishte joadekuat. Sipas QKRVT-së, numri i të burgosurve dhe i të ndaluarve në shumicën e qendrave të ndalimit shënoi rritje. Qendrat e ndalimit në Gjilan dhe Prishtinë nuk i plotësonin standardet minimale. Në korrik, QKRVT-ja vërejti mbingarkesë dhe hapësira të jetesës më të vogla se normat ndërkombëtare në objektin për femra dhe të mitur në Lipjan, ku gjashtë ferma ndanin një qeli. Kushte të ngjashme ishin edhe në qendrën e ndalimit në Mitrovicën veriore. Lipjani ishte e vetmja qendër korrektuese e përcaktuar për femra dhe të mitur dhe, sipas QKRVT-së, kjo qendër nuk mund ta akomodonte numrin gjithnjë e më të madh të të burgosurve. Të miturit jetonin dhe shoqëroheshin me të rriturit.

Autoritetet i mbanin dëshmitarët e dënuar bashkëpunues në të njëjtin objekt me të paraburgosurit në burgun Dubravës, në kundërshtim me ligjin vendor që kërkon akomodim të veçantë.

Sipas raporteve të QKRVT-së, pjesa më e madhe e furnizimeve për kujdes shëndetësor ishin adekuate, por furnizimi me disa barëra themelore mbeti problem. QKRVT i dokumentoi vonesat dhe gabimet në ofrimin e trajtimit mjekësor për të burgosur dhe mungesën e trajtimit të specializuar, si për të varurit nga droga. Në shumë raste, kushtet i detyronin të burgosurit t'i blinin barërat e nevojshme përmes burimeve private. QKRVT vërejti mangësi në sistemin e kujdesit shëndetësor në burgun e Dubravës dhe raportoi për numrin e pamjaftueshëm të profesionistëve të shëndetit mendor.

MPN e vizitoi burgun e Dubravës në qershor dhe raportoi se autoritetet vendosën një të paraburgosur me aftësi të kufizuara mendore në burgosje njësh pasi stafi i burgut në repartin psikiatrik në Prishtinë fizikisht e abuzoi të paraburgosurin. QKRVT vërejti se SHKK nuk i kishte përmirësuar objektet dhe trajtimin për të burgosur me nevoja speciale, edhe pse të burgosurit e tillë i mbante të ndarë nga popullata e përgjithshme e burgut. Nuk pati dispozita ligjore apo udhëzime administrative për trajtimin e të burgosurve me nevoja speciale.

Më 19 shtator, katër të burgosur me një qeli gjoja e dhunuan dhe kërcënuan një të burgosur që vuante një dënim 22-ditësh në burgun e Dubravës për shkaktim të një aksidenti në trafik. Më 9 dhjetor, drejtori i SHKK-së, Shemsi Hajrizi, u tha medieve se rasti ishte duke u hetuar dhe vuri në pah se viktimat e supozuar ishin personi i pestë i vendosur në qeli--ku maksimumi është katër--për shkak të mbipopullimit në Dubravë.

KOSOVA

Administrata: Zyrtarët mbanin shënime për të burgosurit, por administratorët e SHKK-së pohonin se ndarja e përgjegjësive për të paraburgosur dhe të dënuar shkakton probleme. P.sh., autoritetet e burgut nuk mund të intervenonin kur të paraburgosurit me lidhje të mira i përdornin lidhjet në Ministrinë e Drejtësisë për t'u transferuar në lehtësira më komode, si në spitalin e Prishtinës, madje edhe kur burgu ua ofronte shërbimet përkatëse mjekësore. Më 10 dhjetor, EULEX-i dërgoi policinë speciale në burgun e Dubravës për të mbajtur trajnim, për t'i azhurnuar procedurat e operimit dhe për të ndihmuar në kryerjen e funksioneve të sigurisë.

Autoritetet u lejonin vizita të burgosurve dhe ua lejonin ceremonitë fetare, përfshirë të drejtën për të kërkuar vizita nga klerikët. Burgjet dhe qendrat e ndalimit ofronin meny të modifikuara për ceremoni fetare, përfshirë agjërimet/kreshmët fetare.

Të ndaluarit mund t'u paraqitnin autoriteteve gjyqësore dhe IAP-it ankesa dhe kërkesa për hetime, pa censurim, përmes kutive anonime në nëntë prej 10 objekteve të burgjeve. Gjatë nëntë muajve të parë të vitit, të burgosurit ia parashtruan IAP-it 112 ankesa. Të burgosurit u thanë përfaqësuesve të QKRVT-së se nuk i besonin sistemit të brendshëm të ankesave. Sipas zyrtarëve të burgut, kishte katër muaj që pjesë të burgut të Dubravës kishin mungesë të formularëve për ankesa. Monitorët e burgjeve raportuan se Shërbimi Korrektues kishte një problem sistematik të transferimit të të burgosurve prej një institucioni në tjetrin pa e njoftuar të burgosurin apo pa ia ofruar mundësinë për të paraqitur ankesë kundër një vendimit të tillë.

Edhe të burgosurit edhe punëtorët socialë e përshkruanin Panelin për lirim me kusht si “të dobët” për shkak të dështimit për t'i trajtuar kërkesat për lirim të mëhershëm dhe për shkak të mungesës së qartësisë në arsyetimin e mohimeve të tij.

Monitorimi i pavarur: Qeveria nuk u lejoi vizita vëzhguesve të pavarur, joqeveritarë për të drejta të njeriut deri më 14 maj kur Shërbimi Korrektues i Kosovës nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me dy OJQ primare lokale që i monitoronin burgjet, QKRVT-në dhe Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Ministria e Drejtësisë fillimisht e kishte kufizuar qasjen në qendra korrektuese në nëntor të vitit 2013 për shkak të, sipas OJQ-ve, raporteve të tyre kritike. Nga ana tjetër, Ministria e Drejtësisë pohoi se kufizimi kishte ndodhur për shkak të skadimit të lejes së OJQ-së për qasje.

Përmirësimet: Një burg i ri i sigurisë së lartë, me kapacitet deri në 390 të burgosur, u hap në maj afër Podujevës. Monitoruesit i dhanë nota të larta për siguri, lehtësira rekreacioni dhe infrastrukturë, por i kritikuan administratorët që ua ndalonin të burgosurve të dilnin nga qelitë e tyre pas orës 16:00. Deri në dhjetor, në burg ishin 82 të burgosur dhe një staf prej 140 vetash. Sipas QKRVT-së, kjo situatë demonstroi shpërndarje të varfër të resurseve në sistemin e burgjeve, që krijoi vështirësi gjetiu. Sipas EULEX-it, Shërbimi Korrektues i Kosovës investoi 600.000 euro (750.000 dollarë) në qendrën e ndalimit në Mitrovicën veriore.

Qeveria rinovoi pjesërisht kuzhinën e burgut të Dubravës, por objektit ende i mungonin disa pajisje themelore. Në shtator, autoritetet i transferuan tetë të burgosurit e parë në repartin e ri psikiatrik të burgut në spitalin e Prishtinës. QKRVT raportoi se reparti ishte në gjendje të ofronte trajtim adekuat për pacientët me çrregullime mendore.

d. Arrestimi ose ndalimi arbitrar

KOSOVA

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe Qeveria, EULEX-i dhe Forca e Kosovës (KFOR), një forcë paqeruajtëse ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO, në përgjithësi i respektuan këto ndalesa.

Roli i policisë dhe i aparatit të sigurisë

Forcat vendëse të sigurisë përfshijnë PK-në dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). Ligji parashikon që policia të funksionojë nën autoritetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Gjatë këtij viti, shumica e forcave vendëse të sigurisë në Kosovën veriore kaluan nën kontrollin e qeverisë, si pjesë e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë. EULEX-i kishte mandat për t'i monitoruar, mentoruar dhe këshilluar institucionet lokale të gjyqësisë dhe të zbatimit të ligjit; ai gjithashtu kishte disa përgjegjësi operative. EULEX-i gjithashtu kishte mandat të kufizuar dhe të definuar për operacione policore, me autoritet të kufizuar ekzekutiv në raste të krimit të organizuar, korrupsionit të nivelit të lartë, krimeve të luftës, shpëlarjes së parave, financimit të terroristëve dhe bashkëpunimit policor ndërkombëtar. Pasi institucionet qeveritare morën përsipër një numër më të madh të rasteve, roli ekzekutiv i EULEX-it u ul gradualisht, siç parashihet në shkëmbimin e letrave mes qeverisë dhe BE-së.

Policia mban sigurinë e brendshme, e ndihmuar nga EULEX-i si reagues i dytë dhe KFOR-i si reagues i tretë. Autoritetet civile mbajtën kontroll efikas mbi PK-në dhe FSK-në. Pati disa raportime se policia abuzoi të drejtat e njeriut.

Personeli i EULEX-it dhe i KFOR-it në përgjithësi vepronte pa u ndëshkuar nga sistemi ligjor i vendit, por u nënshtrohej procedurave disiplinore të misionit të vet dhe të vendeve të veta përkatëse. Nuk pati raportime për abuzim nga ana e EULEX-it apo e KFOR-it.

Qeveria hetoi abuzimin dhe korrupsionin, ndonëse mekanizmat për ta bërë një gjë të tillë nuk ishin njëloj efikas në tërë vendin. Ligji parashikon që policia të veprojë nën autoritetin e MPB-së. Shumica e forcave vendëse të sigurisë në Kosovën veriore kaluan nën kontrollin e qeverisë, si pjesë e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë.

FSK-ja është forcë civile e reagimit, me armatim të lehtë, e mentoruar nga KFOR-i, që funksionon nën autoritetin civil të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në mars, qeveria miratoi kalimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, por duhej të bëheshin ndryshime kushtetuese para se kalimi të mund të ndodhte.

Në dhjetë muajt e parë të vitit, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), një organ i pavarur në kuadër të MPB-së, shqyrtoi 1.095 ankesa të qytetarëve për sjellje të policëve dhe ndërmori masa për t'ua përcjellë ato institucioneve përkatëse për hetim të mëtejshëm. IPK-ja ia përcolli Njësisë për Standarde Profesionale 552 raste, të cilat i cilësoi si shkelje disiplinore. Ajo i cilësoi 198 ankesa të tjera si raste penale. Deri në nëntor, 250 policë ishin nën hetime.

IPK-ja hetoi shkeljet e rënda disiplinore dhe shqiptoi ndëshkime administrative për kundërvajtje. Deri në nëntor, inspektorati hapi 840 raste, përfshirë rastet e mosbindjes dhe dëmtimit apo humbjes së pronës policore, ndërsa 353 raste të mëhershme mbetën nën hetime.

Procedurat e arrestimit dhe trajtimi i të ndaluarve

KOSOVA

Ligji parashikon që policia mund të arrestojë persona duke përdorur urdhrat e bazuar në prova dhe të lëshuar nga gjykatësi ose prokurori, përveç kur has në një krim që është në zhvillim e sipër. Sipas ligjit, prokurorët duhet të ngrenë padi ndaj personave që i arrestojnë brenda gjashtë orësh duke përdorur gjuhën që e kuptojnë. Autoritet duhet t'i sjellin të arrestuarit para gjyqtarit brenda 48 orësh ose t'i lirojnë. Autoritet duhet t'u sigurojnë të ndaluarve qasje në avokatin të cilin e zgjedhin apo t'ua sigurojnë një avokat. Të dyshuarit gjithashtu kanë të drejtë të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve përveç pyetjeve për identitetin e tyre, për ndihmë falas të përkthyesit, dhe për trajtim mjekësor dhe psikiatrik. Policia nuk mund t'i mbajë të dyshuarit pa mundësi komunikimi.

Pas një aktvendimi fillestar, gjykata mund t'i mbajë individët në paraburgim deri në 30 ditë nga data e arrestimit dhe mund ta vazhdojë paraburgimin e tyre deri në një vit pa ngritur aktakuzë. Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në përfundim të procedurës gjyqësore, vetëm gjykatësi i rastit apo trupi gjykues mund ta urdhërojë apo ndërpresë paraburgimin. Ligji lejon që gjykatësi të urdhërojë arrestin shtëpiak, konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit dhe përdorimin e gjerë të dorëzansisë si alternativa ndaj paraburgimit. Të pandehurit gjithashtu mund të ankohen për paraburgimin e tyre dhe të ndaluarit mund të paraqesin ankesa për ta kontestuar ligjshmërinë ose kushtet e paraburgimit të tyre. Të pandehurit e ndaluar në mënyrë të paligjshme gjithashtu mund të paraqesin padi për kompensim.

Shumica e arrestimeve kryheshin në përgjithësi nga policia, në disa raste nga policë të maskuar apo sekretë, duke përdorur urdhërarrestin. Nuk pati raportime të konfirmuara që policia abuzoi rregullin 48-orësh, dhe prokurorët në përgjithësi ose u ofronin personave të arrestuar dokumente në të cilat cekeshin arsyet për ndalimin e tyre ose i lironin. Zyrtarët në përgjithësi e respektuan kriterin për vendosje të shpejtë të rasteve, por QKRVT-ja raportoi se të ndaluarit nganjëherë përballeshin me vonesa kur avokatët nuk ishin në dispozicion deri në mëngjes pas ndalimit të personit. Gjykatat rrallë herë e përdorën dorëzantinë.

OJQ-të raportuan se autoritetet nuk i lejonin personat e ndaluar të kontaktonin me avokatë me rastin e arrestimit, por vetëm në fillim të marrjes së tyre në pyetje nga policët hetues. Në disa raste, zyrtarët gjoja u mundësuan të ndaluarve qasje në avokat por vetëm pas marrjes formale në pyetje dhe disa të ndaluar ankoheshin që kontakti i tyre i parë me avokatin ndodhte vetëm pas paraqitjes së tyre të parë në gjykatë edhe pse kishin kërkuar avokat menjëherë pas arrestimit të tyre.

Më 8 prill, 11 pjesëtarë të Njësisë Rajonale për Mbështetje Operacionale (ROSU), që është e ngjashme me njësinë SWAT, u gjykuan nën akuzat për keqtrajtim të civilëve gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Rasti ndodhi pasi policia i arrestoi 10 serbë të Kosovës nga Leposaviqi, të cilët ishin në komunën e Graçanicës në janar të vitit 2013, ku ishin në vizitë për të marrë pjesë në krishtlindjet ortodokse serbe. Policia dhe personeli i ROSU-së i transferuan të paraburgosurit në qendrën e paraburgimit në Prishtinë, ku gjoja i rrahën dhe i përqeshën. Në dhjetor të vitit 2013, pas një hetimi të kryer nga inspektorati i policisë në konsultim me EULEX-in, prokuroria e Prishtinës ngriti akuza kundër personelit të ROSU-së. Gjykimi vazhdoi deri më 17 nëntor. Në pajtim me ligjin, të gjithë policët e përfshirë u ricaktuan në pritje të rezultatit të gjykimit.

Paraburgimi: Ndalimet e gjata, para dhe gjatë procedurës gjyqësore, mbetën problem. Ligji lejon që gjykatësi ta shqiptojë masën e paraburgimit nëse ekziston dyshimi i bazuar se personi që ka kryer veprën penale ka të ngjarë t'i shkatërrojë, fshehë apo falsifikojë provat; të

KOSOVA

ndikojë në dëshmitarë; të ikën; ta përsërisë veprën penale apo të kryejë ndonjë veprë tjetër penale; apo të mos paraqitet në procedura gjyqësore. Gjykatësit zakonisht e përdornin paraburgimin pa kërkuar justifikim të mbështetur në prova.

Ndalimi i gjatë--prej tetë apo më tepër muaj-- mbeti problem në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicën jugore, me seli të përkohshme në Vushtrri. Autoritetet rregullisht ua kanë vazhduar paraburgimin të pandehurve që pritin gjykimin gjatë tërë kohës që gjykata punonte me kapacitet të kufizuar. Në gusht, 62 persona, përfshirë tre të mitur, mbetën në paraburgim duke pritur që rastet e tyre të shqyrtoheshin.

Joefikasiteti i gjyqësorit dhe korrupsioni ishin ndër faktorët që shkaktonin shtyrjen e gjykimeve.

Falja: Më 17 shkurt, Presidentja i fali dy persona në përvjetorin e gjashtë të pavarësisë së vendit. Sipas ligjit për amnisti, që është i lidhur me dialogun e Brukselit, prokurorët u dhanë amnisti nga ndjekja penale 1.957 personave, më shumë se dy të tretat e tyre përballeshin me akuza për armëmbajtje pa leje. Organizatat e shoqërisë civile kritikuan zyrtarët e vendit që asnjëherë nuk falën një grua.

e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Kushtetuta parashikon gjyqësor të pavarur, por gjyqësori nuk ofronte gjithmonë proces të drejtë dhe Raporti i Komisionit Evropian për Progresin në Kosovë për vitin 2014 i cilësoi përpjekjet për të ndikuar në hetime dhe raste gjyqësore si shqetësim serioz që duhej ndëshkuar. Pati raportime për korrupsion në gjyqësor dhe sistemi i gjykatave mbeti joefikas. Sipas Këshillit Gjyqësor të Kosovës, mbi 100.000 raste civile e penale pritin të gjykoheshin, mbi 100.000 masa të shqiptuara me vendime gjyqësore pritin të ekzekutoheshin dhe 200.000 padi për kundërvajtje pritin të gjykoheshin.

Një mekanizëm efikas për procedura disiplinore kundër gjykatësve dhe prokurorëve ishte në vend. Autoritetet në përgjithësi i respektuan urdhrat e gjykatave.

EULEX-i vazhdoi të merrte pjesë në sistemin gjyqësor. Shefi i Prokurorisë Speciale, me juridiksion mbi krimet e rënda, përfshirë trafikimin e personave, krimet kundër njerëzimit, shpëlarjen e parave, krimet e luftës dhe terrorizmin, kishte një prokuror të EULEX-it si zëvendës të vetin. Në pajtim me shkëmbimin e letrave mes qeverisë dhe BE-së që ia vazhdoi mandatin EULEX-it, prokurorët e EULEX-it mund të vazhdojnë të veprojnë në mënyrë të pavarur apo bashkë me prokurorët vendorë në pajtim me ligjin në fuqi. 38 gjykatës ndërkombëtare, të punësuar përmes EULEX-it, që i mbështetnin gjykatësit vendorë përfshinin tre gjykatës në Gjykatën Kushtetuese, tetë gjykatës në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, 10 gjykatës në Gjykatën Speciale të Apelit, 10 gjykatës në njësinë mobile për gjykata themelore dhe shtatë gjykatës në Gjykatën Themelore të Mitrovicës me seli në Vushtrri. Siç parashihet në shkëmbimin e letrave, gjykatësit vendorë vazhduan të merrnin përgjegjësi nga EULEX-i.

Më 10 nëntor, Përfaqësuesja e Lartë e BE-së, Federica Mogherini, e caktoi Jean Paul Jacque si ekspert të pavarur ligjor për t'i hetuar akuzat publike ndaj misionit të EULEX-it për korrupsion brenda EULEX-it të bëra nga një ish-punonjës më 27 tetor. Më 6 nëntor, Shefi i

KOSOVA

Misionit të EULEX-it, Gabriele Meucci, deklaroi se hetimi pasqyroj tolerancën zero të misionit për korrupsion.

Si pjesë e zbatimit të vazhdueshëm të dialogut me Serbinë, gjykatat paralele që Serbia i mbështeste në komunat veriore me shumicë serbe i pezulluan funksionet e tyre. Megjithatë, normalizimi i situatës priste një marrëveshje për çështje të drejtësisë mes dy palëve.

Procedurat e gjykimit

Ligji parashikon gjykim të drejtë e të paanshëm dhe gjyqësori në përgjithësi e respektoi ligjin. Gjykimet janë publike dhe të pandehurit gëzojnë prezumimin e pafajësisë, të drejtën për t'u informuar me kohë dhe hollësisht për akuzat kundër tyre, të jenë të pranishëm në gjykimet e veta, të heshtin, të mos detyrohen të dëshmojnë apo ta pranojnë fajësinë, të përballen me dëshmitarë, t'i shohin provat dhe të kenë përfaqësim ligjor. Të pandehurit kanë të drejtë të ankohen. Vendi nuk mban gjykime me juri. Këto të drejta u ofrohen të gjithë qytetarëve pa përjashtim.

Komisioni për Ndhimë Juridike, një agjenci e pavarur qeveritare, u ofroi ndihmë juridike falas personave me të ardhura të ulëta. Pjesa më e madhe e ndihmës së ofruar nga Komisioni ishte për çështje civile ose administrative. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit drejtonte një sektor për avokatë të viktimave, që u ndihmonte viktimave të krimit për të pasur qasje në drejtësi. Ky sektor u ofronte ndihmë juridike falas viktimave të të gjitha krimeve me fokus të veçantë në viktimat e dhunës në familje, trafikimit të personave, abuzimit të fëmijës dhe dhunimit. Ky sektor drejtonte 15 zyra në tërë vendin dhe ofronte ndihmë 24 orë në ditë. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit vazhdoi ta zbatonte një procedurë të re të veprimit për t'i mbështetur viktimat e dhunës në familje dhe avokatët e tyre.

Ministria e Drejtësisë drejtonte sektorin për integrim gjyqësor, i cili i shqyrtonte problemet që ndikonin në pakica. Ministria drejtonte 11 zyra ndërlidhëse të gjykatave për t'u ndihmuar komuniteteve pakicë në zonat e Kosovës me shumicë serbe duke i shoqëruar në gjykata, duke paraqitur dokumente në gjykata në emër të tyre dhe duke u siguruar refugjatëve dhe personave të zhvendosur informata dhe ndihmë juridike.

Prokuroria Speciale i mbikëqyr rastet e krimeve të luftës. EULEX-i mund t'i hetojë dhe gjykojë rastet e tilla vetëm apo, kur është nevoja, bashkë me homologët kosovarë.

Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë

Nuk pati raportime për të burgosur apo të arrestuar politikë.

Procedurat dhe mjetet juridike civile

Pati mjete juridike civile për shkelje të të drejtave të njeriut, por viktimat nuk mund ta shfrytëzonin këtë të drejtë për shkak të procedurave të ndërlikuara burokratike dhe numrit të madh të rasteve të pazgjdhura gjyqësore. Individët mund të ankohen në gjykata për të kërkuar dëmshpërblim për shkelje të të drejtave të njeriut, apo ndalim të shkeljes së të drejtave të njeriut. Individët iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e të drejtave të tyre për proces të drejtë. Ndonëse vendi nuk është nënshkruar i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe prandaj nuk i nënshtrohet juridiksionit të Gjykatës Evropiane për të

KOSOVA

Drejtat e Njeriut, Kushtetuta në mënyrë të qartë i përfshin standardet e Konventës dhe individët mund ta parashtrojnë shkeljen e Konventës në Gjykatë Kushtetuese.

Rikthimi i pronës

Qeveria vazhdoi të shënonte përparim në zgjidhjen e rasteve për rikthimin e pronës. Një përzierje konfuze e ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe praktikave gjyqësore, si dhe rizënia ilegale e pronave dhe ankesat e shumta për të njëjtën pronë e ndërlikonin zgjidhjen e rasteve të të drejtave pronësore.

Komisioni për kërkesa pronësore i Kosovës, i cili vepron në kuadër të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), i vlerëson kërkesat që dalin nga konflikti i Kosovës. Deri në nëntor, Komisioni kishte nxjerrë vendime për 42.687 kërkesa prej gjithsej 42.753 kërkesave të regjistruara. Në këtë numër përfshihen 648 kërkesa që parashtruesit i kishin tërhequr dhe 307 kërkesa që Komisioni i kishte hedhur poshtë si jashtë mandatit të tij. Autoritetet i njoftuan parashtruesit e kërkesave për konkluzionet e veta në 40.347 raste të vendosura. Në të njëjtën kohë, Komisioni raportoi se AKP-ja nuk i kishte zbatuar 13.466 vendime të saj. Deri më 13 nëntor, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së pranoi 1.039 ankesa dhe i referoi 809 sosh në Gjykatën Supreme për masa të mëtejme.

AKP kishte vështirësi në zbatimin e vendimeve të veta gjatë dëbimit të banorëve të paligjshëm, që zakonisht përfshinte refuzimin e serbëve të Kosovës apo shqiptarëve të Kosovës për t'i liruar pronat që ligjërisht u takonin anëtarëve të grupit tjetër. Agjencia shpesh i referonte në polici dhe prokurori për masa të mëtejme rastet e "rizënies serike", në të cilën banorët e paligjshëm ishin dëbuar por ktheheshin për ta zënë pronën.

AKP-ja kishte mungesë të fondeve për të ofruar kompensim për 143 rastet e vendosura nga Drejtoria për Çështje Banesore dhe Pronësore në favor të parashtruesve të kërkesave që i kishin humbur pronat e tyre ë fillim të viteve 1990 për shkak të praktikave diskriminuese banesore që zbatoheshin aso kohe. Agjencia kishte mungesë të fondeve për t'i larguar strukturat e paligjshme të ndërтуara në tokë pasi parashtruesve të kërkesës u ishte konfirmuar e drejta e tyre për tokën.

Numri i pazgjidhur i kërkesave pronësore në gjykata komunale mbeti i lartë. Rreth 7.000 kërkesa mbetën pa u zgjidhur në fund të vitit, që ishin pothuaj vetëm kërkesa financiare të serbëve të Kosovës për pronën e pabanueshme të dëmtuar nga lufta. Përveç kësaj, vendit i mungonte një sistem efektiv për t'u mundësuar serbëve të zhvendosur nga Kosova për të paraqitur kërkesa pronësore dhe kërkesa të tjera nga jashtë vendit.

f. Ndërhyrja arbitrare në intimitet, familje, shtëpi apo korrespondencë

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë veprime të tilla dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto ndalesa.

Seksioni 2. Respektimi i lirive civile, përfshirë:

a. Lirinë e fjalës dhe të shtypit

KOSOVA

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e fjalës dhe të shtypit. Ndonëse Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta, pati raportime që zyrtarë publikë, politikanë dhe biznese përpiqeshin t'i kërcënonin përfaqësuesit e medieeve. Mediet gjithashtu hasën në vështirësi me rastin e marrjes së informatave nga Qeveria dhe institucionet publike, këtë e përkeqësoi edhe më tepër dështimi i Qeverisë për ta emëruar një zëdhënës që nga viti 2010.

Kushtetuta parashikon një Komision të Pavarur për Media (KPM), një organ përgjegjësitetë parësore të të cilit janë t'i rregullojë frekuencat e transmetimit, t'u lëshojë leje transmetuesve publikë e privatë dhe të përcaktojë e zbatojë politika transmetuese. Gjatë marsit dhe prillit, Kuvendi emëroi tre komisionarë të rinj, duke e rritur kështu numrin e tyre në pesë, por dy pozita të komisionarëve mbetën të paplotësuara. Si rrjedhojë, Komisioni përmirësoi funksionimin e vet, por mbeti me mundësi të kufizuara.

Liria e shtypit: Mediet e pavarura ishin aktive dhe shprehën një gamë të gjerë të pikëpamjeve, në përgjithësi pa kufizim; megjithatë, pati raportime për presion verbal ndaj pronarëve të medieeve nga zyrtarët qeveritarë, disa parti politike, biznese të lidhura me Qeverinë dhe disa individë për të mos publikuar storje apo materiale të caktuara. Vështirësitë financiare bënë që pavarësia redaksionale dhe profesionalizmi gazetaresk i medieeve të shkruara dhe elektronike t'i nënshtrohej ndikimit dhe presionit të jashtëm.

Disa medie të shkruara ishin financiarisht të pavarura dhe ishin në gjendje të zhvillonin politika redaksionale të pavarura nga interesat politike apo të biznesit. Mediet me më pak resurse nganjëherë pranonin ndihmë financiare nga një sërë burimesh në shkëmbim për raportim pozitiv apo për mospublikim të storjeve negative që do të mund t'i dëmtonin interesat e financuesve.

Mediet transmetuese kishin më tepër qasje në burime substanciale të të ardhurave sesa mediet e shkruara. Publiku i perceptonte mediet transmetuese si më të pavarura, por stacionet e vogla raportnin se vazhdimisht ishin në rrezik të mbylljes dhe gjithnjë e më shumë vareshin nga burimet e jashtme të financimit për ekzistimin e tyre. Mediet e internetit, që operonin pa rregullore, ushtronin presion të mëtejshëm mbi mediet transmetuese duke ribotuar artikuj nga shtypi ose burime të tjera të internetit pa atribut.

Kuvendi e kontrollon buxhetin e transmetuesit publik, Radiotelevizionit të Kosovës (RTK). Ligji parashikon rregullimin e përmbajtjes së programit të RTK-së dhe kërkon që së paku 15 për qind e kohës së programit të vet, përfshirë kohën qendrore, t'u kushtohet komuniteteve pakicë në gjuhën e tyre përkatëse në baza proporcionale. Ligji kërkon që stacioni i dytë publik, RTK2, të transmetojë së paku 15 për qind të përmbajtjes së vet në gjuhën e pakicave joserbe. RTK2 transmetohej vetëm përmes kompanive kabllore pasi nuk kishte leje për transmetim në frekuenca tokësore.

Më 4 mars, Albert Kastrati, Gani Latifi dhe Driton Dili pranuan fajësinë për akuzat për dëmtim të pronës dhe shkelje të statusit të barabartë të banorëve pasi kishin sulmuar personelin dhe pronën e revistës *Kosova 2.0* gjatë një ndodhie promovuese në vitin 2012. Një gjykatës i Gjykatës Themelore të Prishtinës u shqiptoi të pandehurve dënime njëvjeçare me kusht.

Dhuna dhe ngacmimi: Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe mediet raportuan për disa raste në të cilat zyrtarë qeveritarë apo grupe të interesit afarist abuzuan lirinë e shtypit,

KOSOVA

përfshirë sulmet fizike dhe kërcënimet verbale ndaj gazetarëve, presionin ndaj medieve për të mos publikuar materiale të caktuara, dhe pengimin e punës së gazetarëve.

Më 27 tetor, Sovran Sylja gjoja e theri me thikë në qafë gazetarin e TV Klan Kosovës, Milot Hasimja, në shenjë hakmarrjeje për një raport që gazetari kishte shkruar për të. Autoritetet e arrestuan Sylën në vend të ngjarjes. Kryeministri Hashim Thaçi e quajti sulmin “të patolerueshëm” pasi ai rrezikonte lirinë e shprehjes dhe mendimit. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Medieve të Evropës Juglindore, Olliver Vujoviq, e quajti këtë sulm shkelje të rëndë të lirisë së shtypit.

Më 22 qershor, tre gazetarë, nga Agjencia France Presse (AFP), portali i lajmeve *Express* dhe gazeta *Koha Ditore*, pësuan lëndime në Mitrovicën jugore si rrjedhojë e një proteste të dhunshme në urën Austerlitz. Autoritetet ngrenë padi kundër autorëve të supozuar të sulmit ndaj fotoreporterit të AFP-së, ndërsa vazhduan t’i hetonin pohimet për sulm ndaj reporterit të *Kohës Ditore*.

Më 3 shtator, OJQ-ja Reporterët pa Kufij lëshoi një deklaratë me të cilën kërkonte nga MPB-ja që ta mbronte gazetarin e portalit të lajmeve *Express*, i cili raportoi për islamin politik. Sipas Reporterëve pa Kufij dhe AGK-së, gazetari ishte kërcënuar disa herë me vdekje nga radikalët. Më 17 shtator, një gazetar i *Indeksonline* u kërcënuar me vdekje pas intervistës së 16 shtatorit gjatë të cilës kishte folur në mënyrë kritike për islamin radikal brenda vendit. Policia ishte duke hetuar rastin. Më 23 shtator, IAP tha se kërcënimet ndaj gazetarëve cenonin lirinë e medias.

Më 12 shtator, për herë të tretë, personat larguan dhe dëmtuan pllakën përkujtimore afër qytetit të Rahovecit, e cila përkujton dy gazetarë të zhdukur të Radio Prishtinës, të kidnapuar në vitin 1998. Deri më 1 dhjetor, policia nuk i kishte gjetur as kidnapuesit as personat që e përdhosën monumentin.

Sipas AGK-së, shumë gazetarë ankoheshin që pronarët dhe menaxherët e medieve nuk i lejonin të publikonin apo transmetonin storje kritike për Qeverinë, partitë politike apo zyrtarë të caktuar për shkak të preferencave apo lidhjeve të pronarëve me individët në fjalë. Në disa raste, gazetarët raportonin që pronarët i kërcënonin se do t’i largonin nga puna nëse vazhdonin të publikonin storje kritike për Qeverinë. Disa gazetarë u ankuan që pronarët i ndaluan të publikonin storje për korrupsion të nivelit të lartë në Qeveri.

Censurimi ose kufizimi i përmbajtjes: Ndonëse nuk kishte raporte për censurim të drejtpërdrejtë të medieve të shkruara apo elektronike, gazetarët raportonin që presioni nga politikanët dhe krimi i organizuar shpesh rezultonte në vetëcensurim. Disa gazetarë përmbaheshin nga raportimi hetues kritik për shkak të frikës për sigurinë e tyre personale apo vendin e tyre të punës. Gazetarëve nganjëherë u ofroheshin përfitime financiare në shkëmbim për raportim pozitiv apo heqje dorë nga hetimi dhe zyrtarët qeveritarë dyshonin që kriminelët gojarisht i kërcënonin disa gazetarë për raportimin që konsiderohej negativ. Sipas disa redaktorëve, agjencitë qeveritare dhe korporatat i tërhiqnin reklamat nga gazetaret që publikonin material kritik për to.

Liria e internetit

KOSOVA

Qeveria nuk e kufizoi apo ndërpreu qasjen në internet apo censuroi përmbajtjen në internet, dhe nuk pati raportime të besueshme që Qeveria i vëzhgonte e-mailat apo bisedat në internet pa autoritet përkatës ligjor.

Pothuaj të gjitha zonat urbane kishin qasje të plotë në internet; kurse zonat rurale kishin më pak mbulesë. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare raportoi në nëntor se 58 për qind e të gjitha amvisërive kishin lidhje interneti, ndërsa Internet World Stat raportoi se 76.6 për qind e vendit e përdorte internetin në vitin 2013.

Liria akademike dhe ngjarjet kulturore

Qeveria nuk e kufizonte lirinë akademike apo ngjarjet kulturore.

b. Liria e tubimit paqësor dhe asociimit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e tubimit dhe asociimit, dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto të drejta. Ligji për tubime publike kërkon që organizatorët ta njoftojnë policinë për protesta 72 orë para ndodhisë. Policia duhet t'i njoftojë organizatorët brenda 48 orëve nëse kërkesa e tyre është pranuar.

c. Liria e fesë

Shih *Raportin ndërkombëtar mbi lirinë e fesë* të Departamentit të Shtetit në: www.state.gov/religiousfreedomreport/.

d. Liria e lëvizjes, personat e zhvendosur brenda vendit, mbrojtja e refugjatëve dhe personat pa shtetësi

Ligji parashikon lirinë e lëvizjes brenda vendit, udhëtimin jashtë vendit, emigrimin dhe riatdhesimin, dhe Qeveria e EULEX-i në përgjithësi i respektuan këto të drejta. Megjithatë, tensionet ndëretnike, barrikadat e vendosura nga ekstremistët dhe brengat e vërteta e të perceptuara të sigurisë e kufizonin lirinë e lëvizjes. Brengat e sigurisë gjithashtu penguan një numër të serbëve të zhvendosur të Kosovës që kërkonin të ktheheshin.

Qeveria bashkëpunoi me Zyrën e Komisarariatit të Lartë të OKB-së për Refugjatë (UNHCR) dhe organizata të tjera humanitare për t'u ofruar mbrojtje dhe ndihmë personave të zhvendosur brenda vendit, refugjatëve, refugjatëve që ktheheshin, azilkërkuesve, personave pa shtetësi dhe komuniteteve pakicë të cenuara.

PK e vlerësoi situatën e sigurisë për udhëtarë si stabile por nganjëherë të vështirë. Anëtarët e të gjitha komuniteteve etnike vazhduan të qëndronin kryesisht brenda apo të udhëtonin ndërmjet zonave në të cilat grupi i tyre përbënte shumicën.

Lëvizjet brenda vendit: Disa barrikada të vendosura nga serbët në Kosovën veriore në vitin 2013 dhe viteve të mëparshme ishin hequr, por zyrtarët vendorë serbë të Kosovës vazhduan ta pengonin lirinë e lëvizjes. Më 18 qershor, një kompani ndërtimore me seli në Serbi e hoqi një barrikadë që ishte vendosur qysh në vitin 2011 afër urës Austerlitz ndërmjet Mitrovicës veriore dhe asaj jugore, por komunikacioni u zhvillua vetëm për disa orë. Të nesërmen, punëtorët, të mbikëqyrur nga zyrtarët e Mitrovicës veriore dhe të qeverisë serbe, ngritën një

KOSOVA

barrikadë të re. Më 9 korrik, zyrtarë nga Serbia mbikëqyrën fillimin e ndërtimit të një zone për këmbësorë që do ta ndërpriste qarkullimin e automjeteve në urë. Më 10-11 korrik, banorët shqiptarë të Kosovës në Lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicën veriore vendosën dy mbjellëse betoni dhe simbole nacionaliste në vende të veçanta, duke penguar por jo ndaluar lëvizjen. Deri në fund të nëntorit, BE-ja ishte duke u përpjekur të ndërmjetësonte për një zgjidhje që do ta rikthente lirinë e lëvizjes dhe mbante sigurinë.

Gjetiu në vend, incidentet sporadike të dhunës e kërcënimit vazhduan ta kufizonin lirinë e lëvizjes. Protestuesit shqiptarë të Kosovës i pengonin pelegrinët ortodoksë serbë për të marrë pjesë në shërbimet për krishtlindje dhe ngjitje të Zonjës në Qiell në Gjakovë. Më 28 gusht, protestuesit shqiptarë të Kosovës bllokuan autobusët që bartnin pelegrinë serbë dhe persona të zhvendosur brenda vendit, duke i penguar për të shkuar në kishën ortodokse serbe në fshatin Mushtisht. Policia arrestoi një numër të vogël të protestuesve që përpiqeshin t'i pengonin shërbimet kishtarë.

Personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV)

Sipas UNHCR-së, numri i PZHBV-e mbeti i lartë. Deri në tetor, 17.227 persona ishin të regjistruar si të zhvendosur si pasojë e luftës së vitit 1998-99 dhe dhunës së mëvonshme. Këtu përfshiheshin 9.369 serbë të Kosovës, 7.115 shqiptarë të Kosovës, 280 romë, 242 ashkalinj, 188 egjiptianë, 15 goranë, shtatë boshnjakë dhe 11 persona të përkatësive të tjera etnike. 276 familje të PZHBV-e, me gjithsej 643 anëtarë, ishin të vendosur në 36 strehimore kolektive. Sipas Qendrës për monitorim të zhvendosjes brenda vendit, një numër i madh i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve (RAE) mbetën të paregjistruar dhe të panumëruar nga autoritetet. Shumë prej tyre jetonin në vendbanime joformale të cilave u mungonin rryma dhe shërbimet e tjera themelore.

Një numër i madh i personave të zhvendosur vazhdoi të kërkonte zgjidhje të qëndrueshme në vendet fqinje. Deri në tetor, sipas statistikave të vendeve nikoqire që i janë ofruar UNHCR-së, 90.000 persona janë në Serbi, 936 në Maqedoni dhe 6.141 në Mal të Zi. Rreth 8.000 PZHBV, kryesisht serbë të Kosovës, ia shprehën UNHCR-së interesimin e tyre për t'u kthyer vullnetarisht në vend.

Sipas UNHCR-së, 25.636 persona janë kthyer vullnetarisht në vend që nga viti 2000. 440 persona janë kthyer në 11 muajt e parë të vitit.

Procesi i kthimit pengohej nga incidentet e sigurisë dhe nga ngurrimi i komunitetit pranues për t'i pranuar pakicat që ktheheshin, posaçërisht në Obiliq, Mamushë, Deçan, Gjakovë dhe Mitrovicë veriore. Raportuesi special i OKB-së për të drejta të njeriut të personave të zhvendosur brenda vendit identifikoi mungesën e sigurisë, mbrojtjen joadekuate të të drejtave të personave të kthyer, kërkesat e pazgjidhura pronësore dhe ndërtimore, qasjen e kufizuar në shërbime publike dhe mungesën e mundësive ekonomike si pengesa për kthim. Mungesa e sigurisë dhe marginalizimi i të kthyerve shpesh shpinte në zhvendosje të dytë. Vëzhguesit raportuan që faktorët parësorë që inkurajonin kthimin ishin kushtet e vështira të jetesës në vendin e zhvendosjes dhe pamundësia e PZHBV-e/refugjatëve për t'u integruar në ato vende.

Deri në nëntor, Ministria për Komunitete dhe Kthime u ndihmoi 440 personave të zhvendosur të ktheheshin në vend dhe ndërtoi 37 shtëpi. Ministria gjithashtu u ndihmoi të kthyerve të blinin bagëti, pajisje për ferma dhe mobilie, dhe u ofroi ndihmë për nxjerrjen e dokumenteve

KOSOVA

ligjore dhe të kredive për të filluar ndërmarrje të vogla. Buxheti i Ministrisë për ndihmë për të kthyerit ishte 7,2 milionë euro (9 milionë dollarë) për këtë vit, shumë kjo të cilën donatorët ndërkombëtarë nuk e konsideronin të mjaftueshme për t'i përmbushur të gjitha nevojat. Mbështetja joadekuate për integrim dhe ndihma për pakicat e kthyerat vullnetarisht vazhdoi të ishte faktor kontribuues në zhvendosje të dytë dhe migrim ilegal, posaçërisht për komunitetet RAE të Kosovës.

Në korrik, qeveria miratoi Strategjinë për komunitete dhe kthime 2014-2018, që apelon për zhvillimin e një kornize ligjore për PZHBV. Ministria për Komunitete dhe Kthime formoi një grup punues për të propozuar ligje dhe procedura të reja. Në shtator, Shërbimi i përbashkët për profilizim të PZHBV-e nga Gjeneva, Zvicër, filloi mbledhjen e informatave për mbështetjen e këtij procesi.

Më 27 tetor, autoritetet komunale të Gjakovës demoluan pesë shtëpi që i takonin një familjeje serbe të zhvendosur. Autoritetet pohuan që i kanë zbatuar procedurat e ligjore dhe që shtëpitë ishin të gjysmërrënuara dhe paraqitnin rrezik për siguri. Shoqata e serbëve të zhvendosur nga Gjakova e kontestoi këtë pohim.

Mbrojtja e refugjatëve

E drejta për azil: Ligji parashikon dhënien e statusit të azilantit apo refugjatit dhe Qeveria ka një sistem për t'u ofruar mbrojtje refugjatëve. Qeveria miratoi një sërë rregulloresh për zbatimin e Ligjit për azil të vitit 2013, i cili përmbante përmirësime në pajtim me standardet ndërkombëtare. Vendi nuk ishte destinacioni parësor për azilkërkuesit por pikë transiti për migrim.

Deri në gusht, MBP-ja i ripranoi 2.147 ish-azilkërkues që vullnetarisht u kthyen në vend nga Evropa Perëndimore.

Deri në shtator, prej 682 kërkesave për azil që i kishte shqyrtuar që nga viti 2008, vendi nuk miratoi asnjë kërkesë për azil. Në vitin 2013 dhe në nëntë muajt e parë të vitit, pesë persona morën mbrojtje shtesë, duke u lejuar të qëndronin në vend. Vetëm një mbeti, ndërsa të tjerët e lëshuan vendin. UNHCR-ja nuk pranoi asnjë rast të dokumentuar të dëbimit apo kthimit të detyruar. Autoritetet në pikat hyrëse kufitare nuk kishin shërbime të përkthimit. Sipas UNHCR-së, policia kufitare kishte nevojë për kapacitete shtesë për parakontrollimin e të huajve që kapeshin në kufi. Vendi nuk ka miratuar procedura për trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar.

Nuk pati raportime që autoritetet ndaluan azilkërkues. Megjithatë, autoritetet shpesh i dërgonin të huajt e kapur në kufij në qendrën për azil, ndonëse ata nuk e kishin shprehur zyrtarisht qëllimin e tyre për të kërkuar azil apo për ndonjë nevojë të posaçme për mbrojtje. Ligji për azil parashikon të drejta themelore për azilkërkues dhe refugjatë. Këto të drejta gjithashtu zbatohen për përfituesit e mbrojtjes shtesë apo të përkohshme, të cilët mbesin në vend dhe pranojnë ndihmë për mirëqenie sociale.

Zgjidhjet e qëndrueshme: Sipas UNHCR-së, 56 azilkërkues paraqitën kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në vend gjatë tetë muajve të parë të vitit. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim dhe qendra për azil i akomoduan të gjithë azilkërkuesit.

Personat pa shtetësi

Shifrat zyrtare për persona pa shtetësi nuk ishin në dispozicion. Në tetë muajt e parë të vitit, UNHCR-ja u ndihmoi 495 personave të peregjistruar të komunitetit RAE.

Ligji nuk përmban dispozita diskriminuese të cilat mund të shkaktojnë që grupeve apo individëve t'u hiqet apo mohohet shtetësia. Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet apo për shkak të lindjes në vend.

Ligji parashikon lëshimin e dokumenteve të udhëtimit për persona pa shtetësi dhe ligjet që kanë të bëjnë me gjendjen civile u mundësojnë t'i regjistrojnë lindjet, martesat dhe vdekjet. Zbatimi i ligjeve të gjendjes civile ndryshonte nga komuna në komunë, varësisht nga dallimet në kapacitet apo interpretimet e ndryshme të ligjit. Kapaciteti për t'i identifikuar personat pa shtetësi dhe personat me shtetësi të papërcaktuar mbeti joadekuat.

Mungesa e dokumenteve të identitetit personal e pengonte përfshirjen shoqërore të komunitetit RAE duke i penguar për të pasur qasje në shërbime publike dhe i privonte nga mundësia për t'i mbrojtur të drejtat e veta politike, sociale dhe ekonomike. Anëtarët e peregjistruar të familjeve nuk merrnin ndihma sociale, nuk kishin të drejtë në pension dhe nuk mund të regjistroheshin si titullarë të pronës apo të bartnin të drejta mbi pronën e trashëguar apo të transferuar.

Në mars, Agjencia e Regjistrimit Civil, që vepron në kuadër të MPB-së, e vazhdoi heqjen e pagesës së taksave administrative dhe gjobave për shumë shërbime regjistrimi për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët e Kosovës.

Në maj, vendi u pajtua të bashkëpunonte me autoritetet e Malit të Zi për t'u lejuar rreth 500 romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve të Kosovës, të zhvendosur në Mal të Zi, të paraqitnin kërkesë për dokumente identifikimi dhe për regjistrim të fëmijëve. Një ekip biometrik i MPB-së e vizitoi Malin e Zi disa herë për t'i regjistruar këta persona të zhvendosur.

Seksioni 3. Respektimi i të drejtave politike: E drejta e qytetarëve për ta ndërruar Qeverinë e tyre

Ligji parashikon të drejtën e qytetarëve për ta ndërruar qeverinë e tyre përmes zgjedhjeve të lira e të drejta, dhe ata e ushtruan këtë të drejtë përmes zgjedhjeve në bazë të votimit të përgjithshëm.

Qeveria serbe vazhdoi me shpërbërjen e strukturave paralele ilegale qeveritare në komunat veriore si pjesë e procesit për zbatimin e Dialogut të Brukselit mes Serbisë dhe Kosovës. Disa institucione paralele ilegale gjithashtu vazhduan të vepronin në enklavat serbe në tërë Kosovën jugore.

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Zgjedhjet e fundit: Zgjedhjet e dyta nacionale parlamentare të vendit që nga pavarësia, dhe të parat në të cilat përfshihej Kosova veriore, u mbajtën më 8 qershor. Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe të pavarur e vlerësuan votimin në përgjithësi si të drejtë e të lirë. 30 parti apo grupe politike konkurruan në zgjedhje. Ligji rezervon 10 ulëse për serbët e Kosovës dhe

KOSOVA

10 ulëse për pakicat joserbe. Policia, prokurorët, zyrtarët e zgjedhjeve, dhe gjykatësit formuan një task forcë të përbashkët zgjedhore për ta parandaluar përsëritjen e mashtrimit zgjedhor që i prishi zgjedhjet e vitit 2010. Sipas mendimit të shumë vëzhguesve, përpjekjet e task forcës, që mbështetej nga vëzhguesit ndërkombëtarë e vendorë dhe OJQ-të, rezultuan në nivelin më të ulët të mashtrimit që nga pavarësia. Nuk pati raste të raportuara të dhunës në ditën e zgjedhjeve. Misioni i OSBE-së i mbështeti zgjedhjet në Kosovën veriore.

Partitë politike dhe pjesëmarrja politike: Partitë politike vepronin pa kufizim apo ndërhyrje të jashtme. Lidhja partiace luante rol të madh në qasje në shërbime qeveritare e sociale dhe në mundësi për punësim. Besnikëritë klanore gjithashtu luanin rol të madh, ndonëse jozyrtar, në organizatat politike.

Pjesëmarrja e femrave dhe pakicave: Ligji përcakton kuotën prej 30 për qind për parlamentare dhe 40 femra shërbyen në Kuvendin 120-anëtarësh. Një femër shërbeu si Presidente e vendit dhe femrat shërbyen si zëvendëskryeministre dhe shefe e delegacionit të qeverisë në dialogun me Serbinë.

Kuotat e caktuara për ta mbështetur barazinë gjinore e shtuan numrin e femrave që shërbenin si këshilltare komunale në 338 (665 meshkuj mbanin të njëjtën zyrë). Në 38 komunitat e Kosovës, vetëm një femër ishte kryetare e një komune dhe një femër ishte kryetare e një kuvendi komunal, vetëm nëntë prej 224 kandidatëve për kryetar komune ishin femra. Femrat gjithashtu ishin të nënpërfaqësuar në pozita vendimmarrëse në komuna. Meshkujt i drejtonin 301 prej 315 departamenteve qeveritare në vend.

Seksioni 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në Qeveri

Ligji parashikon dënime penale për korrupsion nga zyrtarët; por Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efikase dhe thuhej që zyrtarët u përfshinë në praktika korruptuese. Sipas organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve, korrupsioni mbeti problem serioz. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit i kontribuan këtij problemi. Pati perceptim të gjerë publik për korrupsion të përhapur në Qeveri.

Korrupsioni: Brenda qeverisë, Agjencia e Kosovës kundër Korrupsionit dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ndanë përgjegjësinë për luftimin e korrupsionit në qeveri. Deri në gusht, agjencia pranoi 130 raporte për korrupsion. Prej raporteve që i kishte shqyrtuar, 60 raste i dërgoi për ndjekje penale, 12 raste në polici dhe 51 i mbylli për shkak të mungesës së provave.

Këshilli Prokurorial i Kosovës raportoi se prokurorët kishin trajtuar 753 raste të korrupsionit, në të cilat ishin të përfshirë 2.044 persona, në gjashtë muajt e parë të vitit. Këtu përfshiheshin edhe 458 raste të pazgjidhura nga vitet e kaluara dhe 295 raste të reja të pranuar deri më 30 qershor. Prokurorët akuzuan 241 të dyshuar. Gjatë kësaj periudhe, gjykatat zgjidhën 48 raste, 34 individë i dënuan, pesë i liruan dhe nëntë aktakuza i hodhën poshtë.

Gjatë këtij viti, ZAP-i auditoi shumicën e Ministrive, Zyrën e Presidentit dhe Kuvendin. ZAP-i shqyrtoi menaxhimin dhe përgjegjësinë fiskale në qeverinë qendrore dhe në administratat komunale. Hetimet nga ZAP-i zbuluan disa shkelje të ligjit që e rregullon prokurimin publik dhe të rregulloreve që i rregullojnë financat publike. Auditorët e kritikuan Organin Shqyrtues të Prokurimit, i cili i mbikëqyr praktikën e prokurimit, pasi punonte pa

KOSOVA

bord të drejtorëve gjatë gjysmës së dytë të vitit 2013, për shpenzim të tepërt të buxhetit të vet vjetor dhe zbatim të praktikave të paligjshme të punësimit. Auditorët gjetën që Organi Shqyrtues i Prokurimit ishte mospërfillës në mbledhjen e gjobave të caktuara kundër autoriteteve kontraktuese. ZAP-i gjeti që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nuk e kishte shpenzuar buxhetin e vet të vitit 2013, i kishte shkelur procedurat për paga të stafit, dhe kishte zbatuar standarde të dyfishta me rastin e vazhdimit të licencave për biznes. Auditorët gjetën që Gjykata Kushtetuese i kishte dhënë rrogë shtesë personelit të vet për punën e kryer gjatë orarit të rregullt të punës.

Më 13 mars, një trup gjykues i përbërë nga gjykatës vendorë e ndërkombëtarë në Gjykatën Themelore të Prizrenit i dënoi kryetarin e komunës Ramadan Muja (PDK) dhe pesë të pandehur të tjerë për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar në katër raste të ndryshme. Të pandehurit u dënuan me nga tri vjet me kusht në lidhje me shpronësimin e paligjshëm të tokës së administratës komunale të Prizrenit. Muja mbeti kryetar komune ndërsa ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

Më 9 shtator, Gjykata Themelore e Prizrenit shpalli fajtorë ish-kryetarin e Gjykatës Komunale të Prishtinës, Nuhi Uka, katër gjykatës të Gjykatës Komunale të Prishtinës, tre gjykatës të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës dhe dy përfaqësues ligjorë për nxjerrje të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore në vitin 2006-07 në 15 raste të tokës. Uka mori dënimin më të madh me kusht. Mediet dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile protestuan kundër këtij vendimi duke thënë që Uka kishte marrë mbi 60 milionë euro (75 milionë dollarë) përmes vendimeve të kundërligjshme gjyqësore dhe nuk kishte marrë dënimin e merituar. Edhe Uka edhe prokurorët ushtroan ankesë kundër këtij aktgjykimi.

Ndërsa korrupsioni mbeti problem në shërbimet policore, PK u mor me hetimin dhe dënimin e praktikave të korruptuara dhe plotësisht bashkëpunonte me agjencitë e caktuara për hetimin e këtyre akuzave, si me IPK-në.

Zbulimi financiar: Ligji i obligon të gjithë zyrtarët e lartë publikë dhe anëtarët e familjeve të tyre që ta deklarojnë pasurinë e tyre dhe prejardhjen e pasurisë së tyre në baza vjetore. Përveç kësaj, zyrtarët e lartë duhet t'i raportojnë ndryshimet në pasuri kur e fillojnë apo ndërpresin shërbimin e tyre në një funksion publik. Agjencia e Kosovës kundër Korrupsionit (AKK) administron regjistrin, verifikon zbulimet dhe i publikon ato në uebfaqen e vet. Gjatë këtij viti, agjencia raportoi se 99,7 për qind e zyrtarëve e deklaruan pasurinë dhe të ardhurat e tyre. Kjo përqindje përfshinte zyrtarët në komunat veriore ku zbulimi ndodhi për herë të parë. Autoritetet mund t'i gjobisin zyrtarët e akuzuar për shkelje të vogla të kriterëve apo t'ua ndalojnë ushtrimin e funksioneve publike deri në një vit. Agjencia ushtroi kallëzime penale në rastet më të rënda.

Qasja publike në informata: Ligji parashikon qasje publike në informata qeveritare dhe gjopa për institucione dhe zyrtarë që nuk ofrojnë qasjen e kërkuar. Qasja në dokumente publike është e drejtë e të gjithë qytetarëve dhe autoritetet ligjërisht mund t'ua mohojnë qasjen vetëm nëse zbulimi i tillë i cenon ose kërcënon interesat nacionale.

Organizatrat e shoqërisë civile i parashtruan shumicën e kërkesave për informata. Qytetarët individualë rrallë e përdorën këtë të drejtë. Organizatat e shoqërisë civile raportuan se institucionet qeveritare rrallëherë ua ofronin informatat ose dokumentet që i kërkonin. Grupet e shoqërisë civile gjithashtu theksuan që gjykatat nuk i procedonin paditë e ushtuara kundër

institucioneve që i injoronin kërkesat për dokumente. Grupet e interesuara e konsideronin këtë mungesë të ndëshkimit si pengesë për efikasitetin e ligjit. Organizatat e shoqërisë civile raportuan se zyrtarët nganjëherë i refuzonin kërkesat e tyre mbi bazën që dokumentet përmbanin informata sekrete pa ia dhënë kërkuarit emrin e institucionit që i klasifikonte dokumentet apo numrin e rastit.

Në qershor, Instituti GAP publikisht kritikoi Ministrinë e Infrastrukturës për ofrim vetëm të qasjes së kufizuar në kontratën për ndërtimin e magjstrales Prishtinë-Han i Elezit, përfshirë dështimin për t'i ofruar përkthimet në gjuhët zyrtare të vendit.

Seksioni 5. Qëndrimi qeveritar në lidhje me hetimin ndërkombëtar dhe joqeveritar të shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut

Një numër i madh i grupeve vendëse dhe ndërkombëtare për të drejta të njeriut në përgjithësi punuan pa kufizim, duke hetuar dhe publikuar konkluzionet e veta për rastet e të drejtave të njeriut. Qeveria nganjëherë bashkëpunonte dhe u përgjigjej pikëpamjeve të tyre. Qeveria nganjëherë takohej me monitorues të OJQ-ve vendëse, u përgjigjej pyetjeve të tyre dhe ndërmerre masa si përgjigje ndaj raporteve apo rekomandimeve të tyre.

Organet qeveritare për të drejta të njeriut: IAP-i ka kompetencë për t'i hetuar pohimet për shkelje të të drejtave të njeriut dhe abuzim të autoritetit qeveritar. Shumica e vëzhguesve të të drejtave të njeriut konsideronin që zyra nuk ishte plotësisht efikase. IAP-i rregullisht i vizitonte të gjitha komunat në vend dhe lëshonte deklarata publike pas ngjarjeve të rëndësishme. IAP-i raportoi se numri i ankesave që kishte pranuar në vitin 2013 ishte 23 për qind më i lartë se në vitin 2012.

Më 19 mars, Kuvendi dështoi ta emëronte një avokat të ri të popullit ndër tre kandidatët e propozuar. Avokati i Popullit në detyrë, Sami Kurteshi, mbeti shef i IAP-it deri në zgjedhjen e një pasardhësi.

Seksioni 6. Diskriminimi, abuzimet shoqërore dhe trafikimi i personave

Ligji posaçërisht ndalon diskriminimin në bazë të seksit, gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, aftësisë së kufizuar mendore apo fizike, orientimit seksual, lidhjes ose bindjes politike, prejardhjes etnike, kombësisë, fesë apo besimit, racës, prejardhjes shoqërore, pronës, lindjes apo ndonjë karakteristike tjetër. Qeveria nuk i zbatonte gjithmonë këto ndalesa në mënyrë efikase.

Femrat

Dhunimi dhe dhuna në familje: Ligji e konsideron dhunimin vepër penale, por nuk e trajton dhunimin bashkëshortor në mënyrë të posaçme. Sipas ligjit, dhunimi dënohet prej 2 – 15 vjet burg dhe dhunimi i të miturës (marrëdhënia seksuale me një fëmijë nën moshën 16-vjeçare) dënohet prej 5 – 20 vjet burg. Dhunimi që përfshin vrasjen dënohet prej 10 vjet burg deri në burgim të përjetshëm. Vëzhguesit besuan që viktimat nuk raportuan në masë të madhe për dhunimin për shkak të turpimit kulturor që u bashkëngjitej atyre dhe familjeve të tyre.

Ligji ndalon dhunën në familje dhe u lejon individëve që ndjehen të kërcënuar të paraqesin kërkesë për lëshim të urdhrin për mbrojtje. Dënimet me burg sillen prej 6 muaj deri në 5 vjet.

KOSOVA

Dhuna në familje ndaj femrave, përfshirë abuzimin bashkëshortor, mbeti problem serioz dhe i vazhdueshëm. Ligji e trajton dhunën në familje si çështje civile, nëse viktimat nuk ka pësuar lëndime trupore. Mosrespektimi i aktgjykimit të një gjykate civile që ka të bëjë me dhunën në familje është vepër penale dhe mund të ndiqet penalisht. Thuhej që policia reagoonte me vend ndaj pohimeve për dhunim dhe dhunë në familje.

Dhuna në familje ngeli forma më e përhapur e dhunës në bazë gjinore, ku pothuaj të gjitha viktimat ishin femra. Në gjashtë muajt e parë të vitit, 389 persona ngritën padi për dhunë në familje. Ekspertët besonin që numri aktual i rasteve të dhunës në familje ishte shumë më i madh. Qëndrimet tradicionale shoqërore ndaj femrave në shoqërinë e dominuar nga meshkujt i kontribuuan shkallës së lartë të abuzimit në familje dhe numrit të vogël të rasteve të raportuara. Avokatët pohonin që viktimat i shmangeshin raportimit të rasteve për shkak të mungesës së besimit në institucionet gjyqësore dhe turpit shoqëror kundër raportimit të dhunës në familje jashtë familjes.

Kur viktimat ngrinin padi, njësitë policore për dhunë në familje kryenin hetime dhe ua kalonin rastet prokurorëve. Shkalla e ndjekjes penale ishte e ulët, të cilën zyra e kryeprokurorit dhe prokuroritë themelore ua atribuonin besnikërive familjare, varfërisë dhe numrit të rasteve të pazgjithura në gjykatat civile dhe penale. Sipas avokatëve të viktimave, dështimi për ta lajmëruar dhunën në familje ndodhte edhe për shkak të mungesës së opsioneve të mundshme për viktimat, përfshirë numrin e vogël të strehimoreve, refuzimin nga anëtarët e familjes dhe mundësitë e pakta për punësim. Dënimet silleshin prej qortimeve gjyqësore deri në dënim me burg.

Qeveria ndërmori masa për ta përmirësuar gjendjen lidhur me dhunën në familje dhe filloi zbatimin e Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje për periudhën 2011-14. Agjencia për Barazi Gjinore ishte përgjegjëse për zbatimin e ndryshimeve të politikave për ta luftuar dhunën në familje, duke propozuar një koordinator vendor dhe duke i ofruar Qeverisë raporte të rregullta. Shumë zyrtarë morën pjesë në ndodhi kushtuar individëve që ishin sulmuar seksualisht gjatë kohës së konfliktit në fund të viteve 1990-të.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale themeloi një njësi kushtuar dhunës në familje. Ministria u siguroi pak përkrahje financiare OJQ-ve që drejtonin 10 strehimore për viktimat të dhunës në familje dhe të trafikimit dhe gjithashtu u ofroi shërbime sociale përmes qendrave për mirëqenie sociale. Disa OJQ vendëse e ndërkombëtare zhvilluan aktivitete për t'u ndihmuar femrave, por përpjekjet e tyre për t'i identifikuar dhe për t'u ndihmuar femrave mbetën në përgjithësi të kufizuara për shkak të traditës së heshtjes lidhur me dhunën në familje, abuzimin seksual dhe dhunimin. Asnjë strehimore nuk punonte në komunat veriore.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike përfshiu kurse mbi të drejtat e njeriut dhe punën me viktimat të dhunës në familje, të dhunimit dhe trafikimit të personave në të gjitha programet e veta të trajnimit themelor për kadetë. Autoritetet mbajtën programe trajnimi për 300 kadetë të rinj gjatë vitit.

Gjymtimi gjeneral i femrave: Vendi ka ligje të posaçme kundër kësaj praktike dhe nuk pati raportime që kjo ka ndodhur.

Ngacmimi seksual: Nuk ka ligj të posaçëm që trajton ngacmimin seksual. Sipas organizatave për të drejta të gruas, ngacmimi seksual në vend të punës ishte i rëndomtë dhe viktimat nuk e

KOSOVA

lajmëronin atë për shkak të frikës nga hakmarrja fizike apo largimi nga puna. Vetëdijesimi publik për ngacmim seksual mbeti i ulët.

Të drejtat riprodhuese: Çiftet dhe individët kanë të drejtë të vendosin lirshëm dhe me përgjegjësi mbi numrin, shpeshhtësinë dhe kohën kur të kenë fëmijë dhe ta arrijnë standardin më të lartë të shëndetit riprodhues pa diskriminim, detyrim dhe dhunë. Ligji mbron të drejtat riprodhuese të individëve dhe çifteve, përfshirë të drejtën për informim dhe qasje në shërbime riprodhuese. Qeveria në përgjithësi i respektoi të drejtat riprodhuese. Fondi i OKB-së për Popullatë raportoi që qasja në informim dhe trajtim të shëndetit riprodhues ishte e përhapur dhe në përgjithësi e drejtë, por komunitetet e varfra, të marginalizuara dhe të pashkolluara shpesh kishin qasje të kufizuara në informata. Qendrat e kujdesit për shëndet publik ofronin trajtim të kufizuar për sëmundjet seksualisht të transmetueshme.

Diskriminimi: Femrat kanë të drejta të njëjta ligjore si meshkujt, por statusi i tyre tradicionalisht më i ulët në familje ndikoi në trajtimin e tyre brenda sistemit ligjor. Agjencia për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit ka mandat për ta zbatuar dhe monitoruar Ligjin për barazi gjinore. Ligji kërkon paga të njëjta për punën ekuivalente.

Relativisht pak femra fituan pozita udhëheqëse të nivelit të lartë në biznes, polici apo Qeveri. Femrat përbënin më pak se 42,7 për qind të fuqisë punëtore të Qeverisë në vitin 2013. Sipas Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, femrat posedonin më pak se 10,5 për qind të bizneseve të regjistruara në vitin 2013 (shih Seksionin 7.d.).

Ndonëse ligji nuk bën dallim në gjini lidhur me të drejtat për trashëgim të pronës, zakonisht meshkujt e trashëgonin pronën e familjes. Ligji përcakton që të dy partnerët në martesë dhe bashkësi civile kanë të drejta të barabarta për ta poseduar apo trashëguar pronën. Megjithatë, vetëm 8 për qind e femrave posedonin tokë. Në raste të rralla, vejushat shqiptare të Kosovës, posaçërisht në zonat rurale, rrezikonin ta humbnin kujdestarinë e fëmijëve të vet për shkak të një zakoni i cili kërkonte që fëmijët dhe prona t'i kaloheshin familjes së babait të ndjerë, ndërsa vejusha të kthehej në familjen e saj. Prova anekdotike sugjerojnë që disa të afërm rrejshëm i deklarorin vejushat jokompetente apo me aftësi të kufizuara mendore për t'ua marrë pronën.

Përzgjedhja e seksit mbi baza gjinore: Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2012, raporti gjinor mes meshkujve dhe femrave të lindur në vend ishte 110,7 me 100. Të dhëna të tjera tregojnë se raporti në popullsinë e përgjithshme ishte 106 me 100.

Fëmijët

Regjistrimi i lindjeve: Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet apo për shkak të lindjes në vend. Sipas një studimi të UNICEF-it të vitit 2009, 8,3 për qind e familjeve dështonin ta regjistronin së paku një fëmijë të tyre kur lindte. Sipas të njëjtit studim, 14 për qind e fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë të lindur në zonat e Kosovës me shumicë shqiptare nuk regjistroheshin kur lindnin. Në rastin e foshnjave që u takojnë këtyre grupeve, por të lindur në zonat ku serbët e Kosovës përbënin shumicën, 5 për qind e tyre nuk regjistroheshin siç duhej. Vëzhguesit i fajësuan edhe zyrtarët edhe familjet për këto mungesa në regjistrim. Mungesa e regjistrimit në përgjithësi nuk ndikonte në mundësinë e fëmijëve për shkollim fillor apo kujdes shëndetësor, por, sipas UNICEF-it, mund të kishte ndikim negativ në qasjen në ndihma sociale.

KOSOVA

Abuzimi i fëmijëve: Përmasat e abuzimit të fëmijëve në vend nuk dihen. UNICEF-i besonte që ky problem nuk raportohet sa duhet për shkak të mungesës së vetëdijesimit publik dhe shërbimit për viktime, dhe mundësisë së kufizuar të autoriteteve për t'i identifikuar, raportuar dhe referuar rastet e abuzimit.

Martesa e hershme dhe e detyruar: Ligji lejon që personat të martohen ligjërisht në moshën 16-vjeçare. Martesa e fëmijëve ishte e rrallë, por vazhdoi të praktikohet në disa komunitete, përfshirë romët, ashkalinjtë, egjiptianët dhe goranët e Kosovës. Qeveria dhe OJQ-të nuk mblodhën të dhëna për martesën e fëmijëve, por Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Agjencia për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit mbajtën fushata informimi për ta dekurajuar këtë fenomen.

Gjymtimi gjeneral i femrave: Vendi nuk ka ligje të posaçme kundër kësaj praktike dhe nuk pati raportime që kjo ka ndodhur.

Praktika të tjera të dëmshme tradicionale: Më 8 janar, një 14-vjeçar nga Suedia, që ishte në vizitë tek të afërmit, u qëllua me armë dhe u vra si rrjedhojë e një gjakmarrjeje. Policia arrestoi një të dyshuar për këtë rast. Më 1 gusht, pjesëmarrësit në një gjakmarrje në fshatin Marmullë të komunës së Gjakovës, vranë një 14-vjeçar dhe xhaxhin e tij.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Moshë minimale për marrëdhënie seksuale me dëshirë është 16 vjeç. Dhunimi i të miturës është vepër penale që dënohet prej 5 – 20 vjet burg, varësisht nga rrethanat dhe moshë e viktimës. Ligji ndalon posedimin, prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë së fëmijëve. Personi që prodhon, përdor apo përfshin një fëmijë në krijimin apo prodhimin e pornografisë dënohet prej një deri në pesë vjet burg. Shpërndarja, promovimi, transmetimi, ofrimi apo paraqitja e pornografisë së fëmijëve dënohet prej gjashtë muaj deri në pesë vjet burg. Posedimi ose prokurimi i pornografisë së fëmijëve dënohet me të holla apo me burg deri në tri vjet.

Rrëmbimet ndërkombëtare të fëmijëve: Vendi nuk është nënshkruar i Konventës së Hagës së vitit 1980 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës.

Antisemitizmi

Më pak se 100 hebrenj jetonin në vend. Nuk pati raportime për akte anti-semitike gjatë vitit.

Trafikimi i personave

Shih *Raportin* e Departamentit të Shtetit *mbi Trafikimin e Personave* në: www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

Personat me aftësi të kufizuara

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara fizike, ndijore, intelektuale dhe mendore në punësim, shkollim, transportim, kujdes shëndetësor apo shërbime të tjera shtetërore. Grupet për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara raportuan se kishte rreth 200.000 persona të tillë. Përkundër kërkesës ligjore që Qeveria t'u ofrojë mbrojtje dhe shërbime të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë, personat me aftësi të

KOSOVA

kufizuara hasën në diskriminim të madh (shih Seksionin 7.d.). Qeveria miratoi strategjinë 2013-23 për përmirësimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të shoqëruar me një plan veprimi për zbatimin e ndryshimeve prej vitit 2013-15. Raporti i Progresit i BE-së për këtë vit nxori në pah dështimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për t'i zbatuar zotimet që i kishte bërë në strategjinë e Ministrisë për t'i vënë asistentët personalë në dispozicion të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ligjet dhe programet për t'u siguruar qasje në ndërtesa, informata dhe komunikim nuk zbatoheshin. Si rrjedhojë, personat me aftësi të kufizuara fizike nuk mund të kishin qasje në ndërtesat komunale, parlament apo shumë spitale dhe shkolla. Personat me aftësi të kufizuara gjithashtu nuk kishin qasje në transport publik për shkak të autobusëve të paarritshëm. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara kishin të drejtë në disa pagesa të vogla sociale nga qeveria. Organizata për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, HandiKos, raportoi që personave me lëndime të boshtit kurrizor, distrofi muskulore, sindromën Down dhe sklerozë të shumëfishtë u mungonte qasja në shërbime themelore dhe në ndihmë sociale.

Ligji parashikon mbrojtje për fëmijët me aftësi të kufizuara. Sipas Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, shtatë shkolla speciale u shërbenin fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe, më 2 tetor, 1.239 fëmijë me nevoja speciale ishin në 76 klasë për fëmijë me nevoja speciale në shkolla të rregullta.

Nuk kishte ligj nacional që e rregullonte procesin e dërgimit të personave në objekte të kujdesit psikiatrik ose social, apo që i mbronte të drejtat e tyre brenda institucioneve të tilla. Objektet e shëndetit mendor ishin nën standarde. Ministria e Punës dhe Ministria e Shëndetësisë kishin mandate të ndara për trajtimin e personave që merreshin me probleme të shëndetit mendor. QKRVT raportoi se, në raste të izoluar, policia i ndalonte personat me aftësi të kufizuara mendore pa kurrfarë baze ligjore. OBSH-ja vlerësoi se ishin 14.000 persona me aftësi të kufizuara mendore. Vëzhgues të tjerë vlerësuan që rreth 50.000 persona me aftësi të kufizuara mendore çonin jetë të izoluar e të stigmatizuar jashtë institucioneve.

Objekti kryesor për persona me aftësi të kufizuara mendore ishte Instituti Special i Shtimes, një kompleks me dy ndërtesa për trajtimin e personave. Gjatë vitit, njëra ndërtesë u shërbente të rriturve me aftësi të kufizuara zhvillimore ose intelektuale dhe trajtonte 63 persona. Ndërtesa e dytë ishte e specializuar në trajtimin e të rriturve me probleme psikiatrike dhe kishte 65 persona, shumica e të cilëve jetonin aty që nga lufta e vitit 1999. Qeveria gjithashtu mbështeti disa "shtëpi riedukimi" për persona me aftësi të kufizuara zhvillimore. Të gjitha, përveç njëjës, u ishin dedikuar të rriturve me aftësi të kufizuara.

Që nga viti 2013, Ministria e Shëndetësisë drejtonte tetë shtëpi për integrim dhe riedukim anëmbanë vendit, të cilat u ofronin shërbime të kujdesit 75 personave me aftësi të kufizuara mendore. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale drejtonte 10 shtëpi të tjera për riedukim me nga 10 deri në 15 banorë. Shumica e banorëve gjoja kaluan vite të tëra në to me pak gjasa për t'u integruar në bashkësi.

Pakicat kombëtare/raciale/etnike

Pakicat etnike, ku përfshiheshin komunitetet serbe, rome, ashkallike, egjiptiane, turke, boshnjake, gorane, kroate dhe malazeze, ballafaqoheshin me shkallë të ndryshme të diskriminimit institucional dhe shoqëror në fushat si punësimi, arsimit, shërbimet sociale,

KOSOVA

përdorimi i gjuhës, liria e lëvizjes, e drejta për t'u kthyer në shtëpi të veta (për persona të zhvendosur) dhe të drejta të tjera themelore. Anëtarët e komuniteteve rome, ashkalike dhe egjiptiane vuanin nga diskriminimi i përhapur shoqëror dhe ekonomik. Atyre shpesh u mungonte qasja në higjienë themelore, kujdes mjekësor dhe shkollim dhe vareshin me të madhe nga ndihmat humanitare për mbijetesë.

Incidentet ku përfshihej dhuna kundër serbëve të kthyer të Kosovës vazhduan, posaçërisht në rajonin e Pejës dhe në komunën e Istogut e të Klinës. Në 11 muajt e parë të vitit pati mbi 269 incidente të vjedhjes, grabitjes, kërcënimit, ngacmimit verbal dhe dëmtimit të pronës së serbëve të Kosovës dhe të kishës ortodokse serbe, ndonëse jo të gjitha i ishin raportuar policisë. Krime kundër komunitetit boshnjakë të Kosovës ndodhën në rajonin e Pejës dhe të Prizrenit, përfshirë vjedhjet, kërcënimet, ngacmimin, dëmtimin e pronës dhe të shtënat me armë në drejtim të shtëpive të të kthyerve.

Gjendja e sigurisë në veri u përmirësua, por mbeti e paparashikueshme. Deri në gusht, autoritetet regjistruan 128 incidente në komunat veriore, përfshirë eksplozime, djegie të veturave, vjedhje, kërcënime dhe dëmtim të pronës. Më shumë se gjysma e këtyre incidenteve ndodhën brenda komunitetit serb të Kosovës dhe nuk ishin me motive etnike. Policia arrestoi të dyshuar në më pak se 10 për qind të rasteve.

Kontestet rreth lejeve për ndërtim penguan ndërtimin e shtëpive në Lagjen Kroi i Vitakut, ndonëse disa ndërtime ndodhën.

Më 22 qershor, rreth 1.000 shqiptarë të Kosovës protestuan dhunshëm kundër pengesave në urën Austerlitz e cila lidh Mitrovicën veriore dhe Mitrovicën jugore. Policia u përgjigj me gaz lotsjellës dhe plumba gome, duke shkaktuar disa lëndime. Më 23 dhjetor, PK shkurtimisht e arrestoi shqiptarin e Kosovës Nazmi Ismajli për rindërtim të shtëpisë së tij pa leje. Të njëjtën datë, ministrja pa portofol, Edita Tahiri, dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor miratuan një memorandum mirëkuptimi mes kryetarëve të komunave të Mitrovicës jugore dhe Mitrovicës veriore për ta ndalur ndërtimin dhe për të zhvilluar plane hapësinore për të dy komunat.

Komisionari për gjuhë, i caktuar në vitin 2013, vazhdoi të monitoronte dhe raportonte mbi zbatimin e legjisllacionit që u jepte status të barabartë dy gjuhëve zyrtare të vendit, shqipes dhe serbishtes. Komisionari pranoi një sërë ankesash, përfshirë ankesat që paketimet farmaceutike nuk ishin në dispozicion në gjuhën shqipe dhe formularët tatimorë nuk ishin në dispozicion në gjuhën serbe. Ndonëse institucionet qeveritare mund të gjobiten për mosrespektim të kritereve gjuhësore, nuk pati raportime për gjobitje. Komisionari nuk kishte kompetenca të drejtpërdrejta për zbatim. Disa prej institucioneve të cilave ua kishte përcjellë rekomandimet e veta shpesh nuk i përfillnin ato. Shumica e institucioneve qeveritare, përfshirë ministrinë, nuk ofronin sasi të barabarta të informatave online në gjuhë të tjera përveç në gjuhën shqipe. Serbët e Kosovës u ankuan që përkthimi në gjuhën serbe i ligjeve, dokumenteve të tjera zyrtare dhe uebsajteve të qeverisë ishte joadekuat edhe pse serbishtja është gjuhë zyrtare e vendit dhe versionet e ligjeve në shqip dhe serbisht kanë rëndësi të njëjtë.

Përfaqësuesit e komunitetit turk gjithashtu shprehën pakënaqësi lidhur me zbatimin e ligjit mbi gjuhët, posaçërisht në komunën e Prizrenit, ku gjuha turke është gjuhë zyrtare. Zyrtarët pohuan që përthimi i emrave të rrugëve dhe i dokumenteve personale mungonte ose ishte i

KOSOVA

dobët. Të meta të ngjashme ndodhën në komunat në të cilat gjuha boshnjake dhe rome kanë status zyrtar.

Punësimi i pakicave në institucione publike mbeti i kufizuar dhe në përgjithësi kufizohej në nivele më të ulëta të Qeverisë. Qeveria nuk pati mekanizma efektivë për monitorimin e niveleve të punësimit të pakicave në institucione publike. Mosnjohja nga qeveria e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës veriore, i cili punon sipas sistemit të qeverisë serbe, ishte pengesë kryesore për punësimin e serbëve të Kosovës dhe të pakicave të tjera në institucione qeveritare (shih Seksionin 7.d.).

Ligji kërkon kushte të barabarta për nxënës, pavarësisht nga gjuha amtare dhe parashikon të drejtën për shkollim publik në gjuhën amtare për nxënës të pakicave, deri në mbarim të shkollës së mesme. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe disa organizata ndërkombëtare raportuan që shkalla e regjistrimit në shkollë ishte më e ulëta ndër komunitetet pakicë jo-serbe, si ashkalinj, boshnjakë egjiptianë, goranë, romë dhe turq. *Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2013* i Komisionit Evropian vuri në pah që fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptianë i vijonin mësimet në shkolla të përziera me fëmijët shqiptarë dhe serbë të Kosovës, por ende vuanin nga shkalla e ulët e regjistrimit, shkalla e lartë e braktisjes së shkollës dhe nivelet e dobëta të të nxënësve. Fëmijët romë ishin më të prapambetur për shkak të varfërisë, gjë që i shtyri shumë prej tyre ta braktisnin shkollën që në moshë të re për të kontribuar në të ardhurat e familjes.

Sipas Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, shkollat që mësimin e mbanin në gjuhën serbe importonin tekste shkollore nga Serbia që nuk ishin në pajtim me dispozitat e kurrikulës vendore. Mësimi në gjuhën boshnjake ishte në dispozicion në shkollën fillore, të mesme dhe në universitet, por vendi nuk ka hartuar tekste shkollore në gjuhën boshnjake. Shkollat ishin të detyruara t'i importonin librat nga Bosnja dhe Hercegovina, vetëm disa prej të cilat ishin miratuar nga Ministria. Probleme të ngjashme patën edhe nxënësit turq.

Aktet e dhunës, diskriminimi dhe abuzimet e tjera të bazuara në orientim seksual dhe identitet gjinor

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e bazuar në orientim seksual, por asnjëri nuk e përfshin në mënyrë të veçantë identitetin gjinor. Kur motivimi për krim është armiqësia e bazuar në gjini, orientim seksual apo lidhje të perceptuar të viktimës me personat që janë objekt i armiqësisë së tillë, ligji e konsideron atë motiv si rrethanë rënduese.

Qendra për Barazi dhe Liri raportoi për disa kërcënime me vdekje online ndaj anëtarëve të saj në tetor dhe nëntor për shkak të orientimit të tyre seksual. PK nuk i gjeti autorët e këtij kërcënimi deri në dhjetor.

Në dhjetor të vitit 2013, qeveria formoi një Grup Këshillëdhënës dhe Koordinues për ta rritur bashkëpunimin mes institucioneve e OJQ-ve vendore e ndërkombëtare që punojnë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetit LHBT. Ky grup punues u takua katër herë gjatë vitit. Qeveria ndërmori hapa për ta sinjalizuar mbështetjen e saj për të drejtat e LHBT-ve duke sponsorizuar disa ngjarje publike, si programin për Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë dhe duke ndriçuar ndërtesën kryesore të Qeverisë me ngjyra të ylberit. Qendra për Barazi dhe Liri i cilësoi këto nisma si tregues të qartë që qeveria i kundërvihet fjalimit urrejtës. Nga ana tjetër, këto ngjarje i nxitën disa intelektualë shqiptarë

KOSOVA

të Kosovës që ta nënshkruajnë një letër me të cilën e denoncojnë homoseksualitetin. Më 17 maj, OJQ-ja e LHBT-ve publikisht përkrahu programin e titulluar Mjekët kundër Homofobisë, duke mbajtur një marsh në mbështetje të LHBT-ve dhe duke i mbështetur publikisht të drejtat e LHBT-ve për herë të parë në Prishtinë. Disa zyrtarë qeveritarë morën pjesë në këtë ndodhi. Policia ofroi siguri dhe nuk ndodhi asnjë incident.

Nuk pati diskriminim zyrtar në punësim, strehim, përcaktim të pashtetësisë apo në qasje në shkollim apo kujdes shëndetësor, por presioni shoqëror e detyroi pjesën më të madhe të LHBT-ve ta fshihnin orientimin e tyre seksual apo identitetin e tyre gjinor. OJQ-të raportuan që diskriminimi i drejtuar ndaj LHBT-ve shpesh kalonte pa u raportuar. Personat LHBT që i raportuan krimet thanë që policët e PK-së nuk ishin të ndjeshëm ndaj nevojave të komunitetit të tyre.

Sipas një studimi të bërë në maj, *Vlerësimi i gjendjes aktuale dhe nevojave të komunitetit LGBT në Kosovë dhe Bosnje dhe Hercegovinë*, nga Mindy Michales, shoqëria fuqishëm dënon homoseksualitetin.

Turpi shoqëror për HIV dhe AIDS

Ndonëse nuk pati raportime të konfirmuara për diskriminim zyrtar ndaj personave me HIV/AIDS gjatë vitit, pati raportime anekdotike për diskriminim të tillë.

Seksioni 7. Të drejtat e punëtorëve

a. Liria e asociimit dhe e drejta për të negociuar kolektivisht

Ligji parashikon të drejtën e punëtorëve për të formuar dhe t'iu bashkuar sindikatave të pavarura dhe të drejtën për të bërë grevë. Ligji ndalon diskriminimin antisindikal dhe shkeljen e të drejtave të punëtorit për shkak të aktiviteteve të tij sindikale. Ligji siguron rikthimin e punëtorëve të larguar për shkak të veprimtarisë sindikale, përfshirë për shërbime themelore. Ligji zbatohet njëllë për të gjithë individët që punojnë në sektorin publik dhe privat, përfshirë migrantët e dokumentuar dhe punëtorët vendorë.

Autoritetet nuk e zbatuan ligjin e punës në mënyrë efektive. Sipas Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), burimet, inspektimet dhe masat mbrojtëse nuk ishin adekuate dhe gjobat nuk mjaftonin. Deri më 13 nëntor, Inspektorati i Punës (IP) i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale lëshoi 120 gjoba që sillleshin prej dënimeve jomonetare deri në 35.000 euro (43.750 dollarë). BSPK tha se këto gjoba nuk mjaftonin për t'i parandaluar shkeljet. Procedurat administrative dhe gjyqësore ishin të ngatërruara dhe u nënshtroheshin vonesave të gjata apo ankesave.

Sipas BSPK-së, Qeveria në përgjithësi e respektoi të drejtën për të formuar dhe për t'iu bashkuar sindikatave në sektorin publik dhe privat. Problem mbeti ndërhyrja e partive politike në organizata tregtare dhe në të drejtat e punëtorëve individualë. Sipas zyrtarëve të sindikatës, punëtorët në sektorin publik zakonisht përballeshin me keqtrajtim, përfshirë ngacmimin seksual dhe humbjen e vendit të punës, për shkak të lidhjes së tyre me parti politike. Punëdhënësit nuk i respektonin gjithmonë të drejtat e organizatave të punëtorëve për të negociuar kolektivisht. BSPK raportoi se shumë punëdhënës të sektorit privat në përgjithësi i injoronin ligjet e punës të vendit. BSPK raportoi për vështirësi të vazhdueshme

KOSOVA

në formimin e sindikatave për shkak të ndërhyrjes së punëdhënësit në shoqatat dhe sindikatat e punëtorëve, posaçërisht në sektorin bankar, të ndërtimitarisë dhe hotelier. Përfaqësues të këtyre sektorëve i thanë BSPK-së në kushte anonimiteti se punëdhënësit përdorën kërcënimin për ta penguar formimin e sindikatave. IP raportoi se nuk kishte marrë asnjë ankesë zyrtare për diskriminim ndaj punëtorëve që u përpoqën t'u bashkohen sindikatave gjatë vitit. BSPK pohoi që IP nuk ishte plotësisht funksional për shkak të mungesës së buxhetit dhe të stafit. OJQ-të monitoronin punën e fëmijës dhe përfshirjen e grupeve të cenuara shoqërore, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, në vend të punës.

b. Ndalimi i punës së dhunshme apo të detyruar

Ligji i ndalon të gjitha format e punës së dhunshme apo të detyruar. Puna e dhunshme e fëmijës ndodhi gjatë vitit (shih Seksionin 7.c.).

Burimet e Qeverisë, përfshirë masat mbrojtëse, ishin të pamjaftueshme për të siguruar zbatim të ligjit, për t'i identifikuar dhe mbrojtur viktimat, dhe për t'i hetuar pohimet për punë të dhunshme apo të detyruar. Gjatë këtij viti nuk pati hetime, ndjekje penale apo dënime për punë të dhunshme për shkak të, sipas IP-së, burimeve joadekuate për ta hetuar këtë çështje. Dënimet silleshin prej pesë deri në 12 vjet burgim dhe ishin mjaft të rrepta në krahasim me dënimet për krime të tjera të rënda. Autoritetet nuk larguan asnjë viktimë nga puna e dhunshme gjatë vitit.

Shih gjithashtu *Raportin e Departamentit të Shtetit mbi Trafikimin e Personave* në: www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

c. Ndalimi i punës së fëmijës dhe mosha minimale për punë

Mosha minimale për punë është 15 vjet, nëse puna e tillë nuk është e dëmshme për fëmijën apo nuk e pengon atë për ta vijuar mësimin. Nëse puna ka të ngjarë ta rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e të rinjve, mosha minimale ligjore është 18 vjet.

Rregulloret ndalojnë shfrytëzimin e fëmijëve në vend të punës, përfshirë punën e dhunshme apo të detyruar. Qeveria e mbështeti një task forcë kundër trafikimit, e cila filloi të ndërhynte në raste të punës së dhunshme apo të rrezikshme. Kjo task forcë ishte e kufizuar për shkak të burimeve të pakta.

Inspektorët menjëherë i njoftonin punëdhënësit kur i gjenin të miturit duke punuar në kushte të rrezikshme. Gjatë vitit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale regjistroi 206 raste të të miturve që punonin në kushte të rrezikshme. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe IP theksuan se për shkak të bashkërendimit të dobët mes institucioneve të vendit dhe mungesës së një depoje të centralizuar, numri i rasteve aktuale ishte shumë më i lartë. Sipas Ligjit të punës, inspektorët mund t'i gjobisin punëdhënësit prej 100 euro (125 dollarë) deri në 10.000 euro (12.500 dollarë) për shkak të detyrimit të një punëtori për të punuar në kushte të rrezikshme të punës. Gjobat ishin të dyfishta për veprat penale të kryera kundër një të mituri. Zbatimi ishte i dobët për shkak të trajnimit joadekuat dhe burimeve të pamjaftueshme. Ligji parashikon ndëshkime shtesë për punëdhënësit dhe familjet që i angazhojnë fëmijët në praktika të punës ose që dështojnë t'i përmbushin detyrimet e tyre prindërore duke rezultuar në punësim të paligjshëm të të miturit. Nëse përcaktohet që është në interesin më të mirë të fëmijës, ligji u lejon autoriteteve ta largojnë një fëmijë nga shtëpia.

KOSOVA

ILO raportoi se fëmijët që punonin në sektorin e bujqësisë dhe të minierave hasnin në rreziqe që lidheshin me pajisjet për punë në bujqësi dhe nxjerrje të mineraleve nga vendet në të cilat arrihej me vështirësi. ILO gjithashtu raportoi se numri i fëmijëve lypsarë në rrugë të qyteteve vazhdoi të shënonte rënie, por numri i përgjithshëm i fëmijëve lypsarë nuk dihej. Ndonëse shumica e fëmijëve rrallëherë ishin siguresit kryesorë të të ardhurave për familjet e tyre, puna e fëmijës shërbeu si kontribut i madh në të ardhurat e disa familjeve.

Fëmijët e rinj në zonat rurale shpesh u ndihmonin familjeve të veta në punë bujqësore, zakonisht pas mësimit. Fëmijët e qytetit shpesh punonin në një sërë punësh jozyrtare në ndërtimtari dhe të shitjes me pakicë, si shitja e gazetave, cigareve dhe kartelave të telefonit në rrugë. Disa fëmijë gjithashtu merreshin me punë fizike, si transportimi i mallrave.

Shih *Konkluzionet e Departamentit të Punës mbi format më të këqija të punës së fëmijës në: www.dol.gov/ilab/reports/child-labor/findings/.*

d. Diskriminimi në lidhje me punësimin ose profesionin

Ligji ndalon çdo lloj diskriminimi, përfshirë përjashtimin ose parapëlqimin në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, moshës, gjendjes familjare, mendimit politik, prejardhjes nacionale apo sociale, gjuhës apo anëtarësimit në sindikatë, që ndikon në anulimin ose dëmtimin e barazisë së mundësisë ose trajtimit në ndërtimin e kapaciteteve në punësim ose profesion. Ligji posaçërisht ndalon diskriminimin në bazë të gjinisë dhe vlen për qasje në punësim, vetëpunësim dhe zgjedhje të profesionit. Ndalimet përfshijnë diskriminimin në kushtet për gradim dhe rekrutim në cilëndo degë të aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale. Gjobat janë të trefishta në rastet e diskriminimit të ndaluar me ligjin që rregullon punën. Ligji nuk mbron nga diskriminimi në bazë të identitetit gjinor, statusit HIV, sëmundjeve të tjera ngjitëse apo kufizimeve fizike.

Diskriminimi në punësim dhe profesion ndodhi në lidhje me seksin, gjininë, aftësinë e kufizuar dhe statusin minoritar (shih Seksionin 6). Gjatë vitit, BSPK-ja pranoi raporte prej sindikatave të punës dhe individëve që pohonin për diskriminim në bazë të moshës dhe gjendjes familjare. BSPK-ja vuri në pah se punësimi varej pothuaj ekskluzivisht nga statusi dhe lidhja politike e punëtorit. BSPK-ja gjithashtu theksoi se për shkak të papunësisë së lartë, punëtorët ngurronin ta raportonin diskriminimin, duke iu frikësuar hakmarrjes nga punëdhënësi i tyre. Punëtorët më së shpeshti i trajtonin çështjet e tyre të punës brenda dhe jozyrtarisht me punëdhënësit e tyre. BSPK-ja gjithashtu raportoi që punëdhënësit nganjëherë në mënyrë të paligjshme i përjashtonin femrat që ishin shtatzënë ose kërkonin pushim të lehonisë.

Sipas ligjit, të huajt duhet të marrin leje për punë para se të kërkojnë të punojnë në vend. Sipas IP-së, nuk pati raportime që punëtorëve të huaj u ishin mohuar lejet e punës dhe nuk pati raportime që të drejtat e punëtorëve të huaj ishin shkelur gjatë vitit.

e. Kushtet e pranueshme të punës

Rroga minimale e caktuar nga qeveria ishte 130 euro (163 dollarë) në muaj për punëtorët nën moshën 35-vjeçare, dhe 170 euro (213 dollarë) në muaj për punëtorët mbi moshën 35-vjeçare e më të vjetër. Programet për ndihmë sociale mund t'u ofronin familjeve pa burime të

KOSOVA

mjaftueshme deri në 80 euro (100 dollarë) në muaj, dhe një individ mund të merrte deri në 40 euro (50 dollarë) në muaj. Familjet dhe individët mund të merrnin fonde shtesë për fëmijë, të kishin zbritje në rrymë elektrike dhe beneficione të tjera.

Ligji parashikon javën standarde të punës prej 40 orësh, kërkon periudha pushimi, kufizon numrin e orëve të rregullta të punës deri në 12 orë në ditë, kufizon punën jashtë orarit deri në 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj, kërkon pagimin e bonusit për punën jashtë orarit, dhe ndalon punën e tepërt e të detyrueshme jashtë orarit. Ligji parashikon 20 ditë pushim me pagesë në vit për punëtorë dhe tre muaj për pushim të lehonisë. Ligji i punës i përcakton standardet e shëndetit dhe të sigurisë për vende të punës dhe qeveris me të gjitha industritë në vend.

Inspektorët e IP-së ishin përgjegjës për zbatimin e standardeve të punës, shëndetit dhe sigurisë, ndonëse 51 inspektorët e punësuar gjatë vitit nuk mjaftuan për ta monitoruar me efikasitet sektorin zyrtar dhe jozyrtar. Deri në dhjetor, këta inspektorë kryen 9.377 inspektime të rastit dhe të planifikuara. IP i këshilloi punëdhënësit mbi përmirësimet për të vepruar në pajtim me rregulloret në vend të punës dhe shkeljet që do të mund të rezultojnë në sanksione zyrtare. Deri në dhjetor, IP shqiptoi 1.502 vërejtje për shkelje të ndryshme të standardeve të punës dhe shqiptoi 171 gjoba shtesë deri në 35.000 euro (43.800 dollarë) për moskorrigjim të shkeljeve të cituara. Deri më 15 dhjetor, IP pranoi 467 ankesa kundër gjobave dhe vërejtjeve të shqiptuara nga inspektorët e punës. IP i zgjodhi këto ankesa prej 15 deri në 60 ditë. Gjatë vitit, IP vlerësoi se do t'i nevojiteshin 150 inspektorë për t'i monitoruar punëdhënësit në mënyrë adekuate ose për të ndikuar në zbutjen e problemeve të punës. Inspektorati i konsideronte gjobat financiare të pamjaftueshme për t'i dekurajuar shkeljet. Inspektorët zakonisht u jepnin punëdhënësve kohë të mjaftueshme për t'i korrigjuar shkeljet para se t'ua shqiptonin gjobat.

Sipas IP-së dhe BSPK-së, ligji i punës është gjithëpërfshirës dhe dispozitat e tij sigurojnë mekanizma adekuate për mbrojtje të barabartë të punëtorëve në sektorin publik dhe privat. Sipas BSPK-së, mungesa e zbatimit të ligjit nga qeveria ishte rrjedhojë e numrit të pakët të punëtorëve të sindikatës, si dhe e IP-së që nuk kishte personel dhe kompetenca të mjaftueshme.

Qeveria miratoi kontratën kolektive, që do të hynte në fuqi më 1 janar 2015, e cila i përcakton të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëtorit, përfshirë dispozitat mbi orët e punës, punën e natës, pushimin vjetor, pushimin e lehonisë, sigurinë në punë dhe beneficionet shëndetësore të punëtorit. Kontrata gjithashtu përfshin të gjitha mbrojtjet e parapara në ligje të punës dhe vlen për të gjithë punëtorët në ekonominë zyrtare dhe jozyrtare. Vëzhguesit theksuan se marrëveshja kishte për qëllim ta reduktonte ekonominë jozyrtare duke i gjobitur punëdhënësit që nuk i regjistronin punëtorët.

Sipas BSPK-së, punëdhënësit dështonin t'i respektonin standardet zyrtare të punës të cilat siguronin standarde të barabarta të mbrojtjes për punëtorët në sektorin publik dhe privat. BSPK raportoi për mungesë të mbikëqyrjes qeveritare dhe të zbatimit, posaçërisht lidhur me javën standarde të punës dhe punën e detyrueshme e të papaguar jashtë orarit. Shumë individë punonin me orar të gjatë në sektorin privat, kinse sipas dëshirës së tyre, pa kontratë pune, pagesë të rregullt apo kontribute pensionale të paguara në emër të tyre. BSPK raportoi se punëdhënësit nuk i përfillnin dispozitat ligjore dhe i përjashtonin punëtorët pa arsye në kundërshtim me ligjin dhe refuzonin t'i respektonin festat e punëtorëve. Deri në tetor, IP

KOSOVA

pranoi 374 ankesa zyrtare për shkelje të të drejtave të punëtorëve në sektorin publik dhe privat. Organizata për të drejta të gruas raportuan se abuzimi dhe ngacmimi seksual ndodhte në vend të punës, por kalonte i paraportuar për shkak të frikës për përjashtim nga puna apo hakmarrja.

Ndonëse ligji parashikon mbrojtje të shëndetit të punëtorëve dhe kushte të punës, institucionet private dhe publike nuk e respektonin atë nganjëherë. Zyrtarët e IP-së raportuan për vështirësi në marrjen e informatave të sakta për zbatim pasi punëtorët rrallë i zbulonin problemet për shkak të frikës për humbje të vendit të punës. IP-ja raportoi për 9 fatalitete dhe 63 aksidente të rënda në vend të punës deri më 15 dhjetor.

Asnjë ligj në veçanti nuk i lejon punëtorit ta lërë punën për shkak të një situatë të rrezikshme të punës, por ligji kërkon që çdo punëdhënës t'u sigurojë kushte adekuate të punës të gjithë punëtorëve duke u bazuar në kërkesat e punës. Sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, marrëveshjet jozyrtare punëdhënës-punëtor mund ta trajtojnë çështjen kur dhe nëse një punëtor mund ta lërë punën për shkak të situatave të rrezikshme të punës. Institucionet e vendit nuk i kanë shqyrtuar këto marrëveshje.